

ALI ALIU
DON KISHOTI SHQIPTAR

BOTIMET TOENA

ALI ALIU

DON KISHOTI SHQIPTAR

Një histori ndryshe e letërsisë shqipe

Ribotim i zgjeruar

BOTIMET TOENA
Tiranë

Botimi i parë 2010
Botimi i dytë 2012

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-13-0

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA
Rr. "M. Gjollështa", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

Perspektiva e vizionit dhe iluzionit donkishotesk në perceptimin e jetës, të botës dhe të njeriut, të Shqipërisë dhe të shqiptarëve në letërsinë shqipe, ka qenë ide ngasëse për shkrimin dhe botimin e parë të veprës “Don Kishoti shqiptar” (Një histori ndryshe e Letërsisë shqipe) në maqedonisht (2003), me kërkesën e shtëpisë botuese “Kultura” nga Shkupi. Siç dihet, në këtë botim të konceptuar enkas për lexuesin maqedonas, qenë përfshirë vetëm Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Fan Noli, Faik Konica, Lasgush Poradeci, Ismail Kadare, Ali Podrimja dhe Luan Starova. Vepra në fjalë, nga lexuesi dhe mendimi kritik u prit mirë, ndoshta prandaj nxiti edhe botuesin nga Sofja që ta përkthente në gjuhën bullgare gjashtë vjet më vonë (2009) dhe ta promovonte në po atë vit.

NË GJURMIM TË REFLEKSEVE KUPTIMORE
TË DON KISHOTIT SERVANTESK
NË LETËRSINË SHQIPE

Një shënim paraprak:

- Edhe tani, edhe këtu, do ta them atë që e kam thënë shumë herë deri tani dhe në shumë raste paraprake: nëse nuk kam kualifikimin publik të albanologut (edhe pse kam shumë dëshmi edhe për një kualifikim të tillë), unë, sipas bindjes sime personale, paraqitem nga pozita e albanofilit. Besoj se askush nuk është as i aftë, as i autorizuar që të ma marrë këtë të drejtë...

Me kolegun Xhevat Gega, profesor në Fakultetin Filologjik “Bllazhe Konevski” në Shkup, tani në pension, para dy-tre vitesh ishim parashtues të propozimit drejtuar Këshillit, për çmimin më të lartë republikan “11 Tetori”, që ky çmim publik t’i jepej akademikut Ali Aliu. Shkak ishte botimi i librit “Don Kishoti shqiptar”. Në të vërtetë, atëherë pata rastin fatlum të njihem me tekstin e këtij libri të mrekullueshëm, për të cilin tani më jepet mundësia të shprehem.

Shefi i Katedrës së Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe, prof. dr. Nehas Sopaj më nderoi me ftesën që publikisht të shprehem për veprën e përmendur të Ali Aliut. Me kënaqësi pranova nderin që m’u ofrua dhe do të tentoj të shpaloj një vlerësim timin të shkurtër. Është mirë ta bëj të ditur se me kolegun Ali Aliu njihemi prej shumë vitesh dhe në disa raste kemi bashkëpunuar në projekte për kuptimësimin e kulturës së ndërsjellë shqiptaro-maqedonase.

Duke pasur mundësi të flas në kohën e duhur, të jem një nga lexuesit e parë të veprës së tij, **in media res** do të them dhe do të nënvizoj një përfundim (jo vetëm përshtypje) se ky është një libër i bukur, libër i idesë fatlume, origjinal dhe inventiv. Libër në thelbin e të cilit janë shqyrtimet depërtuese analitike, deri te të cilat, edhe sipas sistemit të tyre edhe sipas angazhimit në shkencën e letërsisë dhe artit letrar, vështirë se mund të arrijnë shumica e dijetarëve të njohur letrarë. Ideja, apo shkathtësia që të vëzhgosh reflekset e kuptimit të ndërlikuar e të ndërlikur me emrin dhe aventurat e heroit kryesor (personazhit) në romanin e njohur me të njëjtin emër të shkrimtarit spanjoll Miguel Servantes, së pari i botuar në fillim të shekullit XVII (viti

1605), i kuptimit, nocionit, metaforës, parabolës dhe paradigmës, fjalës së urtë që gjatë rrjedhës katërqindvjeçare mrekullon lexuesit e planetit tonë me asociacione të panumërta, të ndërlidhura për një frymëzim produktiv të një fisniku të cilit iu desh t'i japë një grusht mirësi dhe korrigjime botës së padrejtë, që t'i ndihmojë me vepra njerëzit e pambrojtur.

Kuptohet, përfytyrimi figurativ i këtij bamirësi të mbinatyrshëm, në të vërtetë një ëndërrimtar të pasionuar dhe fantazuesi të palodhshëm, ka qenë lëndë e interesimit më të gjerë të arteve (letërsisë, muzikës, arteve pamore) dhe nga këtu burojnë edhe versionet e shumta të profilizimit të tij, e që e thamë një herë - janë veçanërisht të pasura. Reflektet domethënëse të Don Kishotit ishin të njohura sidomos në artin e fjalës së shkruar, që nga Hajnrih Hajne e Fjodor Dostojevski, e deri tek Unamuno e Ortega- i- Gaset, si dhe tek ideja fatlume e Ali Aliut që ta ndjekë këtë lidhje të veçantë specifike dhe të modifikuar, këtë sintezë, përmbledhje, perceptim e pranim të heroit të veçantë spanjoll, në rrjedhat letrare të gjuhës shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, duke ndikuar pozitivisht në to.

Bëhet fjalë për diçka specifike, jo gjithaq tematiko-përmbajtjesore, sa ide, nxitje, stimulim, të cilën autori i veprës do ta quajë - një lexim i mundshëm i letërsisë shqiptare! Në të vërtetë, në hyrjen e tij, të destinuar si një orientim i përgjithshëm për lexuesin maqedonas, autori, Ali Aliu e komenton me pasion, rreptësi dhe saktësi këtë koncept të qartësuar:

“Me një singeritet dhe qëllim të mirë, kjo vepër i ofrohet lexuesit maqedonas me të vetmin qëllim që të plotësohet sa është e mundur “deficiti tradicional” lidhur me informatat e pakta nga fusha e historisë kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve. Ajo mund të konsiderohet po kështu vazhdimësi e tentimeve fisnike që në dekadën e fundit janë bërë nga ana e disa shkrintarëve maqedonas, bashkë me autorin e këtij libri, por edhe nga të tjerë, që të prezantohen veprat më të rëndësishme nga letërsia shqiptare në gjuhën maqedonase”.

Kështu thuhet në fillim të fjalës hyrëse të autorit të këtij libri, Ali Aliut, drejtuar lexuesve maqedonas: “Kur takova një Don Kishot fatlum”.

Menjëherë do të shtoj disa informata të duhura: këto fjalë shpjegojnë thelbin e këndvështrimit autorial, andaj edhe janë koment për arsyet e përcaktimit që në nëntitull është përshkruar si “një lexim i mundshëm i letërsisë shqiptare!”. Mirëpo vlerat e veprës për të cilën flasim, janë krejt diçka tjetër, apo, sipas meje, qëndrojnë shumë më lartë se këto deklarata të qëllimshme të autorit. Këto vlera janë thelbi më i rëndësishëm: zbulojmë një vepër e cila rrumbullakon një tërësi tematike dhe e cila, nëpërmjet konceptit të përcaktuar qartë, ofron pasqyrim origjinal të një qasjeje të thellë studiuëse

ndaj temës për të cilën ka qenë i nevojshëm një rrafsh më i lartë i njohurive dhe interpretimeve. Nuk është ky libër i njohjes nominale shkollareske, as doracak për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, nuk është as përmbledhje “qëllimmirë” dhe “praktike apo e dobishme” për shkollat. Këtu nuk është me rëndësi se sa janë dhe cilët janë autorët për të cilët bëhet fjalë. Ata janë tetëmbëdhjetë përfaqësues të fjalës letrare shqipe (nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia), të cilët veçohen si dominues, superiorë, eminentë, të njohur, e që quhen: (1) Jeronim de Rada, (2) Naim Frashëri, (3) Fan Noli, (4) Faik Konica, (5) Lasgush Poradeci, (6) Fatos Arapi (7) Dritëro Agolli, (8) Ismail Kadare, (9) Azem Shkreli, (10) Ali Podrimja, (11) Luan Starova, (12) Xhevahir Spahiu, (13) Kim Mehmeti, (14) Zija Çela, (15) Eqrem Basha, (16) Sabri Hamiti, (17) Mehmet Kraja, (18) Zejnullah Rrahmani. Ata janë përfaqësues antologjikë të fjalës letrare. Dhe zgjedhja si zgjedhje pasqyron njohjen, shijen, arsyen e vlerësimit tematik dhe estetik, por, të gjithë autorë të moshës jo të njëjtë dhe nga periudha të ndryshme kohore, janë të ndriçuar nga reflektorët e qëndrimit që e thamë se është - vrojtim i thellë, e si i tillë paraqet shenjë njohëse të dimensionit të ndërlikuar donkishotian në përcaktimin dhe rrumbullakimin e tyre programor.

Vetë autori, Ali Aliu, si bartës i një koncepti të qartësuar për kuptimin e projektit të tij, do të na vetëprezantohet (nëpërmjet parafjalës) me këtë deklaratë:

“Përfytyrimi i itinerarit donkishotesk të Servantesit në zbulimin dhe pasqyrimin e autorëve shqiptarë, e me këtë edhe prezantimi i një pasqyre të mundshme dominuese të rrjedhave letrare shqiptare në këto dy shekujt e fundit, erdhi dhe u përforcua në mënyrë spontane si shtytës i pashmangshëm, sidomos me rileximin e parathënies së dikurshme që Fan Noli ia bën përkthimit të veprës epokale të shkrimtarit të njohur gjenial spanjoll...

... vepra mori njëkohësisht karakter të ri, u bë shekuj me radhë paradigmë e pakapërcyeshme e shumë popujve dhe njëkohësisht, fitoi një kuptim të madh psikologjik dhe ushtroi një ndikim të madh moral dhe universal për njerëzimin. Ky roman rrezaton edhe sot aktualitetin si dhe me dramaticitetin virtual dhe estetik. Nuk ka shkrimtar që nuk do kishte dëshirë dhe që nuk ëndërron me penën tij si shtizë, me vetëdije a pa të, të bashkërenditet me “falangën donkishoteske” të Servantesit. Përmes një imagjinate të përsosur me të cilën na prin, përmes forcës me të cilën depërton thellë në ndërgjegje dhe në emocione, në dobësitë dhe krenaritë, përmes sfidës së shqetësimit të ndjenjave dhe pasionit, Don Kishoti rinjohet lehtësisht si hero gati i çdo populli në botë. Ne nuk kemi ndërmend ta shëtisim Don Kishotin nëpër

letërsinë shqiptare të dy shekujve të fundit duke e mbajtur peng lexuesin në aventurën e tij...”.

Ja motivet e gjenezës së librit.

Dhe radhiten në parafjalën e autorit edhe shumë sqarime tjera, të vlefshme dhe të pashmangshme për t’u lënë pa u përmendur, si ai se: fenomeni i artit letrar imponon njohuri për atë që arti i fjalës, me forcën e imagjinatës së vet, në mënyrë universale dhe të përhershme, e definon dhe e qartëson identitetin njerëzor, fatin e tij të pamposhtur, i jep kuptim jetës së njeriut në këtë univers të pafundmë dhe të panjohur. Dhe Ali Aliu do të përfundojë: *“Letërsia mbetet rojtari i pamposhtur i mbamendjes njerëzore në të mirën e ruajtjes së identitetit të tij”*. Pa dyshim se këtu diku është fokusuar edhe lajmotivi i librit: me çelësin e Servantesit të hapen dyert hyrëse në shpirtin enigmatik të shqiptarisë.

Janë prekur probleme dhe domethënie të një ekzistimi nacional nëpërmjet retrospektivës së donkishotizmit dhe antidonkishotizmit. Kuptimet kryqëzohen dhe plotësohen nëpërmjet faktografisë, e cila na zbulon lindje specifike dhe thujtje të veçanta të letërsisë jashtë mjedisit amë, kryesisht, duke ndjekur problemin e çrrënjëzimit, egzilit, dëbimit, qëndrimit ndaj gjuhës, problemin e dyamësisë së letërsisë etj. Dritë e veçantë hidhet mbi problemin e përkatësisë së dyfishtë të shkrimtarëve dygjuhësorë, do të thoshim që nga Jeronim de Rada e deri te Luan Starova. Interesante janë aspektet nëpërmjet të cilave zbërthehen këto çështje. Sidoqoftë, shembujt dhe komentet e Ali Aliut do të inspirojnë shumë përfaqësues të shkencës bashkëkohore maqedonase letrare që edhe ata t’i qasen problemit të përkatësisë së dyfishtë në letërsi, nëpërmjet teoremave që i elaboron Ali Aliu, sepse edhe letërsia maqedonase njih shembuj të panumërta të profileve letrare, për të cilët Ali Aliu thotë se kurrë nuk janë çrrënjësuar nga përkatësia e parë dhe kurrë nuk janë rrënjësuar në përkatësinë e tyre të dytë. Sa për ilustrim, do të shtoj se të këtij lloji letrarësh, te maqedonasit numërojmë Gligor Përliçevin, Trajko Kitançevin, Koço Racinin, Venko Markovskin, Nikolla Kirov Majksin, Marko Cepenkon, D. Milenskin, Efrim Sprostranovin, Nikolla Merovin etj. Ali Aliu këtë e quan “shtytje donkishoteske e iluzioneve”. E tërë kjo është një ngërç dëshpërues për të shpëtuar gjuhën amtare.

Libri i Ali Aliut “Don Kishoti shqiptar”, është libër i veçantë për lexuesit që kanë shije. Është ndjekur një përplasje e thellë e identitetit dhe skrupujve realë, është ndjekur ndërlikueshmëria e ruajtjes së identitetit, suptiliteti dhe delikatja e mbrojtjes së asaj që është e jotja.

Duhet të ndajmë edhe disa minuta që të shpalosim disa vrojtme që janë të pashmangshme:

Fakti jo i rëndomtë dhe simbolik i cili nuk kërkon vetëm të shënohet, por do një koment më të gjerë, është ai se, libri i Ali Aliut “Don Kishoti shqiptar” më parë u botua (i adaptuar nga Mirlinda Krivca) në përkthim në gjuhën maqedonase dhe pas kësaj edhe në formën burimore. Kjo rrethanë habitëse shpjegon shumëçka, e më së shumti atë se është gjesti i vullnetit të mirë dhe një shkallë më suptile e parashikueshmërisë konceptuale. Do të thotë, në rend të ditës është vënë mundësia e sprovimit të respektit të ndërsjellë.

Të gjithë këta donkishotë dhe antidonkishotë të llojit të vet shqiptar, të vënë në shënjestër në librin e Ali Aliut, ndërlidhen me vepra që shkojnë kah Evropa - të gjithë ata, nga Jeronim de Rada deri te Kim Mehmeti, ecin nëpër shtegun e iluzionit, por nëpërmjet aktit të deziluzionit se në të vërtetë caku i quajtur Evropë sidoqoftë është i arritshëm. Ali Aliu e ndjek atë shteg, atë kolonë krenare, meritore të diellndriturve, të shenjtorëve gojartë, të profetëve dhe mjeshtëurve këmbëngulës të mendimit dhe fjalës. E ndjek Ali Aliu këtë ekspeditë triumfale dhe bubulluese të quajtur nga ai, *frymëzim donkishotian*, andaj do të më lejoni që edhe unë, apo më mirë të them, pikërisht unë ta quaj këtë libër të mprehtë dhe mjeshtëror, libër të një njohësi të shumëfishtë letrar, i cili nëpërmjet fjalëve të sakta dhe të zgjedhura, ka arritur t’i prezantojë të arriturat shkrepëtitëse të trembëdhjetë lartësuesve të merituar të gjuhës shqipe dhe shpërndarësve të mendimit letrar dhe kombëtar shqiptar, të tetë kalorësve të zgjedhur të nderit e të përzgjedhjes thelbësore artistike, dinjiteti i të cilëve deri te zbulimi lucid (të themi plotësisht i afërt me kategorinë e zbulimeve kolumbiane) njihej edhe para Ali Aliut, por ja, atij, pikërisht atij i ra në hise ta shpalosë atë shenjë dhe ato tipare, ato karakteristika artistike dhe historike - me librin që do të mbetet në mbamendjen kulturore të rrethit të popujve ballkanikë si arritje kulmore dhe si krenari e begatë e shkencës letrare. Gjesti i autorit që të shpaloset dhe së pari herë të prezantohet në gjuhën maqedonase me këtë vlerë të rrallë, vetëm i pasuron dimensionet fisnike të veprës. Në përgjithësi, ky është shembulli dhe formula e një libri të veçantë që zgjeron horizontin e shpresës.

Me këtë, e përmbyllim përshtypjen përfundimtare me autorë siç është pa dyshim edhe Ali Aliu. Pas daljes në dritë të një libri të këtillë - me të drejtë do të mburren së pari tri mjediset kulturore dhe gjuhësore të cilave u përket autori (Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria), ndërsa reflekset e tyre të frytshme, jam i bindur se së shpejti do t’i marrin edhe shfrytëzuesit qëllimmirë përreth (të Ballkanit), sepse ja, shfaqet edhe e rëndomta në të parëndomtën, kuptohet, jo si çudi, as si kundërçudi, por si logjikë dhe arsye

e natyrës: të jemi dëshmitarë të gjallë të një dukurie, pa dyshim gazmore, të një autori paralajmërues dhe të talentuar, siç është Ali Aliu, flatrat e të cilit janë më të mëdha seç e ka folenë!

Gane Todorovski

HYRJA

KUR TAKOVA NJË DON KISHOT TË LUMTUR

*(Një lexim i mundshëm i letërsisë shqipe)*¹

* * *

Me një sinqeritet dhe qëllim të mirë, kjo vepër i ofrohet lexuesit maqedonas me të vetmin qëllim që të plotësohet sa është e mundur “deficiti tradicional” lidhur me informatat e pakta nga fusha e historisë kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve. Ajo mund të konsiderohet po kështu vazhdimësi e tentimeve fisnike që në dekadën e fundit janë bërë nga ana e disa shkrimtarëve maqedonas, bashkë me autorin e këtij libri, por edhe nga të tjerët, që të prezantohen veprat më të rëndësishme nga letërsia shqiptare në gjuhën maqedonase. Kështu, qëmoti janë afirmuar, në maqedonisht, disa nga vlerat e rëndësishme të autorëve shqiptarë, siç janë: Naim Frashëri, Lasgush Poradeci, Fan Noli, Jeronim de Rada, pastaj autorët bashkëkohorë Sterio Spasse, Ismail Kadare (shtatë vepra), Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Azem Shkreli, Anton Pashku, Murat Isaku, Abdylaziz Islami, Xhevahir Spahiu, Ali Podrimja, Resul Shabani, Visar Zhiti, Kim Mehmeti, Flutura Aça, Lindita Ahmeti etj. Në këtë mision historik letrar maqedonas-shqiptar, rol të veçantë kanë luajtur autorët maqedonas, siç janë: Gane Todorovski, Ante Popovski etj.

Libri “Don Kishoti shqiptar” mëton ta zgjerojë hapësirën e këtyre informatave të lexuesit maqedonas, të cilit i janë servitur prej vitësh informata të njëanshme dhe tendencioze, shpesh edhe paragjykime të shtresuara ndër vite, sidomos për shqiptarët e Maqedonisë, në të shumtën e rasteve me qëllime të caktuara ditore politikaneske.

Libri ka për qëllim të ndriçojë në mënyrë kritike dhe reale, disa autorë të dalluar shqiptarë, ndër më të afirmuarit në botë, veprat e të cilëve artikulojnë vlera të qëndrueshme, universale dhe kombëtare dhe qëndrojnë majave të artit letrar të Ballkanit.

¹ Versioni i parë i librit është shkruar në maqedonisht, i porositur nga botuesi i Shkupit “Kultura”, në vitin 2003.

* * *

Përfytyrimi i itinerarit donkishotesk të Servantesit në zbulimin dhe pasqyrimin e autorëve shqiptarë, e me këtë prezantim i një pasqyre të mundshme dominuese të rrjedhave letrare shqiptare në këto dy shekujt e fundit, erdhi dhe u përforcua në mënyrë spontane si shtytës i pashmangshëm, sidomos me rileximin e parathënies së dikurshme që Fan Noli ia bën përkthimit të veprës epokale të shkrimtarit të njohur gjenial spanjoll.

Vëllimi i parë i veprës “Don Kishoti” i Servantesit, u botua për herë të parë në Madrid, në vitin 1605. Kjo satirë me një iluzion romanesk, me një pasqyrë të çuditshme të jetës, u bë këtyre pesë shekujve ndër lekturat unikale dhe të përhershme planetare. Vepra mori njëkohësisht karakter të ri, u bë shekuj me radhë paradigmë e pakapërcyeshme e shumë popujve dhe njëkohësisht, fitoi një kuptim të madh psikologjik dhe ushtroi një ndikim të madh moral dhe universal për njerëzimin. Ky roman rrezaton edhe sot aktualitetin si dhe dramacitetin virtual dhe estetik. Nuk ka shkrimtar që nuk do të kishte dëshirë dhe që nuk ëndërron të bashkërenditet me penën e tij si shtizë, me vetëdije a pa të, të bashkërenditet me “falangën donkishoteske” të Servantesit. Përmes një imagjinate të përsosur me të cilën na prin, përmes forcës me të cilën depërton thellë në ndërgjegje dhe në emocione, në dobësitë dhe në krenaritë, përmes sfidës së shqetësimit të ndjenjave dhe të pasionit, Don Kishoti rinjohet lehtësisht si hero gati i çdo populli në botë. Ne nuk kemi ndër mend ta shëtisim Don Kishotin në letërsinë shqiptare të dy shekujve të fundit duke e mbajtur peng lexuesin në aventurën tonë...

* * *

Si një veprimtari e rrallë krijuese artistike njerëzore, krijimtaria letrare, falë imagjinatës së pakufishme, e përkufizon dhe e vërteton në një mënyrë të përhershme dhe universale identitetin njerëzor, e zbukuron papërkulshmërinë e tij të pafat, i jep kuptimësi jetës njerëzore në universalitetin e panjohur e të pafundmë. Letërsia mbetet një sogjetar i papërkulur i kujtesës së njeriut në përpjekje për të ruajtur identitetin e tij.

Shqiptarët, të shpërndarë në të gjitha kontinentet, por të përqendruar në mënyrë integrale dhe më homogjene në Ballkan, ku, sipas kufijve (që gjithnjë e më tepër po e humbin kuptimin para integriteteve reale evropiane), ende vazhdojnë të jenë të ndarë me vetveten, pothuajse pesë shekuj me radhë (duke u nisur që nga libri i parë në gjuhën shqipe i vitit 1555, e deri te botimi i veprave të Ismail Kadaresë dhe receptimi i tyre historik në botë), e ruajnë identitetin e tyre letrar.

Identiteti historik shqiptar ka qenë mbajtur në periudha shekullore dhe më gjerë nga shkrimtarët që kanë shkruar dhe janë realizuar edhe në gjuhë të huaja, që kanë marrë pjesë në betejat për ide evropiane të cilat nuk ishin të tyre, që janë shquar në lëvizjet shpirtërore avangarde evropiane, edhe pse ato mund të ishin larg aspiratave të Rilindjes Kombëtare të Ballkanit. Ata kishin krijuar monumente letrare universale, përkundër mosekzistimit të shtetit të tyre të pavarur kombëtar. Ata fati i kishte përplasur në një opozitë të huaj avangarde. Pothuaj të gjithë autorët shqiptarë, të shpërndarë mes Ballkanit dhe Evropës, mes Bizantit dhe Romës, mes Ballkanit dhe Perandorisë Osmane, mes traditës dhe modernitetit, kishin mbetur peng të një **“donkishotizmi”** specifik, fare pak i njohur nga popujt e tjerë. Përprojekja për të bërë pak më shumë drejt historisë së tyre, duke besuar në mundësitë e pafundme të imagjinatës dhe mundësive polivalente, poliforme gjuhësore, prej këtyre autorëve do të krijojë “donkishotistët” e papajtueshëm, të cilët në periudha të gjera e të gjata kohore do t’ia dorëzojnë stafetën donkishoteske njëri-tjetrit duke besuar se jetën e tyre e kishin lidhur për kauzën e madhe: mbrojtjen e identitetit gjuhësor të popullit të tyre.

* * *

Duke dëshiruar që ky libër t’u ofrojë lexuesve, të cilët i kam parasysh, në një hapësirë më të gjerë të odisejadës donkishoteske të letërsisë shqipe, të vetëdijshëm për mundësitë e pakufishme të saj, përcaktuam për autorët e prejardhjeve të ndryshme kohore dhe hapësinore, të cilat udhëhiqen nga një (anti)donkishotizëm, si kategori specifike letrare që realizohet në kohë dhe hapësira e që, nga ana tjetër, burojnë në vepra të rëndësishme të cilat, lart dhe me dinjitet, e kishin obliguar kulturën dhe letërsinë shqiptare që nga Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Fan Noli, Faik Konica, Lasgush Poradeci e deri te Fatos Arapi, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Azem Shkreli, Ali Podrimja dhe Luan Starova, Xhevahir Spahiu, Kim Mehmeti. Këtyre autorëve mund t’u bashkohen edhe autorë të tjerë me vlerat e tyre të pakontestueshme letrare, por qëllimi ynë kryesor është të gjurmojmë një vijë të trazuar të “antidonkishotizmit”, që na duket orientimi më i mirë për të provuar plotësinë e letërsisë shqipe të këtyre dukurive eminente në periudha të caktuara nga e kaluara, përfshirë hapësirën e të vërtetave shqiptare.

* * *

Dhe në fund do të doja t’ia zbuloja lexuesit maqedonas një fshehtësi të sinqertë. Ky libër, me këtë përfytyrim dhe projektim, për herë të parë si integrum, po paraqitet para lexuesit maqedonas. Ai, jo rastësisht ka një

frymëzim të veçantë, një kuptim dhe arsyetim si një përcaktim autorial dhe besim për një mirëkuptim më të mirë, njohje dhe zbulim të vlerave reciproke, si një garanci për përcaktimin për një jetë të përbashkët pa kufij, një jetë me tjetrin dhe jo një jetë pranë tjetrit.

Autori është i vetëdijshëm se marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve në Republikën e Maqedonisë, jo që nuk shkëlqejnë, por përkundrazi janë të ngarkuara me probleme. E megjithatë, është fakt i njohur se ndërmjet tyre nuk ka pasur ndonjë konflikt përmasash të rënda gjatë së kaluarës, apo urrejtje të pakapërcyeshme. Mund të thuhet se vëllavrasjet e tmerrshme si në Bosnjë, Kroaci e Serbi, maqedonasit dhe shqiptarët edhe pas konfliktit të përgjakshëm të vitit 2001, i kanë shmangur dhe arritën të vazhdojnë jetën e përbashkët në një shtet, me gjithë antagonizmat e gjallë të proveniencës etnike. Qëndrueshmëria e bashkëjetesës ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve është një garanci në “përmbylljen evropiane të jetës sonë” dhe jo vetëm një shmangie e konfliktit të mundshëm, por një modus vivendi i ri evropian ndërmjet ballkanasve. Me një mirëkuptim drejt një perspektive që nuk është e pamundshme, në krahët e njohjes dhe rinjohjes reciproke reale dhe të vërtetë, kjo mund të zbulojë një sërë vlerash të përbashkëta në sferën e traditave, folklorit, jetës kulturore si dhe një sërë fenomenesh të përbashkëta të cilat janë të pashmangshme në jetën e përbashkët në një gjeografi dhe histori të njëjtë.

Libri “Don Kishoti shqiptar”, si një botim i parë në gjuhën maqedonase, para shqiptarëve merret si një kontribut për misionin e një njohje më të mirë, më të thellë dhe më të gjithanshme të shqiptarëve, për fatin e tyre integral nga ana e lexuesit maqedonas.

Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare e zotëron gjuhën maqedonase dhe në një pjesë të Maqedonisë popullata maqedonase flet shqip (Prespë, Resnjë, Dibër e vise të tjera), madje sot nuk është i paktë numri i maqedonasve të rinj të cilët interesohen ta mësojnë gjuhën shqipe. Realizimi i këtij libri në gjuhë maqedonase është menduar, përgatitur dhe përkthyer nga shqiptarët. Këtë autori nuk e pandeh një donkishotizëm, por fitore reale të kohës sonë.

Akti i njohjes i gjuhës së tjetrit, prezantimi i thelbit të identitetit të tyre para palës tjetër, sidoqoftë ka qenë akt humaniteti dhe tolerance universal, një donkishotizëm shqiptar. Edhe pse kultura dhe letërsia shqiptare shkruhej në masën më të madhe, sidomos në shekullin e XIX, në gjuhën e të tjerëve, në qendrat e largëta evropiane, tej vendit amë, ajo vazhdoi të ushqejë përherë dhe pandërprerë nga donkishotizmi i frymës dhe i shpirtit shqiptar. Nëse zbulohen porosinë e thella humane të kësaj letërsie dhe kulture dhe anasjelltas, do të krijohet një bazë e gjerë dhe reale për një

bashkëjetesë mirëkuptim dhe kapërcimit të pengesave objektive, për një jetë të përbashkët. Shqiptarët janë ndër të rrallët, në mos të vetmit në Ballkan, të cilët pa kurrfarë rezerve e pranojnë identitetin maqedonas, krejt ndryshe nga fqinjët e tjerë të këtij populli ballkanas.

Ky libër ka për qëllim t'i shërbejë, para së gjithash, lexuesit të zakonshëm maqedonas, njohësit dhe studiuesit të letërsisë, artit letrar në përgjithësi, dashamirësit të fjalës së bukur dhe të shpirtit - thjesht atij që ka kërshëri dhe vullnet t'i njohë fatet, të kaluarën, vlerat e njerëzve, pranë të cilëve dhe me të cilët është paracaktuar të jetojë. Udhëtimi i Don Kishotit me shpirt e iluzion shqiptar nëpër dy shekujt e fundit, ka për qëllim ta shpalosë botën e shkrimtarit, ngasjen e tij të brendshme për të ëndërruar, përkatësisht për të përqendruar tërë qenien e vet drejt gjetjes së rrënjëve dhe të identitetit, drejt realizimit të ëndrrës së madhe. Dhe në fund, zgjedhja jonë që të përqendrohemi në jetën dhe veprën e autorëve të cilët ekziston "gjeni" (anti) donkishotesk, përputhet me faktin se këta autorë janë ndër më të shquarit në letërsinë shqiptare të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe njëzet, e njëkohësisht edhe ndër më të përkthyerit në botë.

KAPITULLI I

DON KISHOTI I LUMTUR NË BABILON
- *Gjurmëve për një gjuhë poetike të Jeronim de Radës* -

JERONIM DE RADA
Jeta dhe veprimtaria letrare
(1814-1903)

Lindi dhe vdiq në fshatin Maki të Kalabrisë. Mësimet e para i mori në Kolegjin e Shën Adrianit, në Shën Mitër Koronë, kurse shkollën e mesme e kreu në Shën Benedeto Ulano. Në Universitetin e Napolit vazhdoi studimet për drejtësi. Mori pjesë në lëvizjen revolucionare të kohës. Më 1848 botoi revistën “L’ Albanese d’Italia” (Shqiptari i Italisë), ndërsa më 1849 emërohet mësues i gjuhës shqipe në Katedrën e Gjuhës Shqipe, të Kolegjit të Shën Adrianit. Në këtë kohë fillon të merret aktivisht me shkrime. Shkruan, boton, përpunon nga të gjitha fushat, duke filluar nga poezia, gjuhësia, folklori etj. Më 1868 emërohet drejtor i gjimnazit në Garapoli të Korilianos së Kalabros. Ndërsa më 1883 fillon të botojë revistën “Flamuri i Arbërit” shqip e italisht, e cila së shpejti bëhet tribunë e çështjes sonë kombëtare. Me veprimtarinë e gjithanshme patriotike, letrare, kulturore Jeronim de Rada u bë frymëzuesi dhe udhëheqësi shpirtëror i shqiptarëve të Italisë. Punoi dhjetë vjet në gjimnazin e Korilano Kalabros. Më 1899 në Kolegj hyri përsëri mësimi i gjuhës shqipe, ku De Rada përsëri bëhet mësues i saj dhe aty punon deri në vdekje. Gjithashtu, gjatë viteve 1896-1897 punoi intensivisht në organizimin e dy kongreseve gjuhësore të arbëreshëve, ndërsa më 1899 merr pjesë në Kongresin e orientalistëve në Romë me një temë nga gjuha shqipe. Vitin e fundit të jetës De Rada i kaloi në vetmi dhe varfëri, i dhënë tërësisht mbas çështjes kombëtare duke shkruar dhe botuar vepra me karakter historiko-gjuhësor. De Rada botoi një numër të konsiderueshëm veprash, shumicën në gjuhën italiane, por edhe në gjuhën shqipe, sidomos veprat poetike në vargje. Veprat e De Radës u botuan në disa qendra të Italisë, gjë që tregon rëndësinë dhe karakterin e tyre të qëndrueshëm.

Veprat: “Milosao” 1836 - Napoli, “Serafina Topia” 1839 - Napoli, “Numidët” 1836 - Napoli, “Rrëfime të Arbërit” 1847 - Napoli, “Odisea” 1874 - Napoli, “Parimet e estetikës” 1861 - Napoli, “Lashtësia e kombit shqiptar” 1864 - Napoli, “Letër dërguar Gjon Francisko Stamillës” 1865

- Kozencë, “Rapsodi të një poemi arbëresh” 1866 - Firenze, “Gramatika e gjuhës shqipe” (me Zef de Radën) 1871 - Firencë, “Skënderbeu i pafan” 1873 - Koriliano Kalabro, “Kolegji i Shën Adrianit” 1876, “Kolegji Arbëresh” 1884, “Pellazgët dhe shqiptarët” 1890 - Napoli, “Leksionet e gjuhës shqipe” 1891, “Sofonisbo” 1891 - Napoli, “Katedra e gjuhës shqipe e Shën Mitër Koronës” 1892, “Konferencë mbi lashtësinë e gjuhës shqipe” 1892 - Napoli, “Tiparet dhe gramatika e gjuhës” 1894, “Antologjia e shqipes” 1896 - Napoli, “Pasqyra e një jete njerëzore” 1898, “Karakteri i gjuhës shqipe” 1898 - Katancaro, “Autobiologjia I, IV” 1898 - Kozencë, “Autobiologjia II, III”, 1899 - Napoli, “Testamenti politik” 1902 - Katanxaro etj.

Që sot duhet të mësohemi për sa do të jemi gjithmonë ndër shekujt...

Brodski, 1982

Unë jam nga ata që mendojnë se para varrit të njeriut siç ishte Jeronim de Rada, pak fjalë duhet të thuhet dhe pak shkojnë... ai në vitin 1936 në moshën njëzetedyvjeçare, e shkroi eposin e tij historik për Milosaon në mënyrë që për herë të fundit të shkruante kur kishte mbushur 86 vjeç. Mes këtyre datave janë 60 e më shumë vjet, kurse De Rada shkroi shumë vepra në gjuhë shqipe, por edhe në gjuhë italiane, porse për herë për Shqipërinë dhe shqiptarët...

Faik Konica, 1903

I.

Çdo njeri ka një botë të vetën, në të cilën zbulohet me gjuhën e tij. Cila është kjo gjuhë? Çfarë tonaliteti ka uni personal? Është tepër vështirë që të kuptohet deri në fund kjo enigmë. Pas Babilonisë, dihet, njeriu e humbi gjuhën e tij të parë. Ai do të vazhdojë ta ruajë kujtimin e “gjuhës së humbur”. Që atëherë, njeriu do të mbetet, në njëfarë mënyre, mërgimtar gjuhësor i përjetshëm në cilindoqoftë vis të planetit, do të gjurmojë pas gjuhës së tij, si një Don Kishot i lumtur në Babiloni.

Duke ndjekur fatin e Don Kishotit të lumtur në Babiloni, i udhëhequr nga intuita e vet e pazëvendësueshme, nën ngasjen e një demoni të brendshëm, nga një zjarr i fjetur por kurrë i shuar, shkrimtari bën që ta rigjejë gjuhën e parë, edhe atëherë kur fati e jeta e çojnë dhe e përplasnin në mjedise gjuhësh të tjera. Ai do ta rigjejë patjetër nëse me vete ka marrë një pamje, ngjyrë, melodi e shije, qoftë edhe të trashëguar tërthorazi nga prindërit, nga gjuha e të parëve të vet. I nxitur si nga kërshtëria, ai do ta zbulojë për së dyti gjuhën e vet, nëse fati ia ka dhënë ta ketë fiksuar në atdheun e tij ose në një nga gjuhët ndryshe nga gjuha e tij, por edhe nëse fati e shpie në vend tjetër dhe për çdo rast dhe kudo qoftë, nëse ashtu është thënë ta shkruajë gjuhën e vet. Natyrisht që kjo nuk është rrugë gjithaq e lehtë. Por, kur ndodh, kjo rrugë mund të jetë vërtet frytdhënëse: do t’i ndizet flakadani i krijimtarisë, do t’i ndizen burimet e vërteta të krijimtarisë. Zhan Zhak Ruso thoshte se zjarri i krijimtarisë ka zanoret, të cilat e prekin thellësinë e shpirtit dhe tingujt e fjalëve janë shumë më të thella se sa kuptimi i tyre. Që nga fillimi uria dhe etja nuk do të jenë faktorët kryesorë të cilët do ta detyrojnë njeriun të gëzohet: ngasja e parë do të jetë dashuria, urrejtja, zemërimi, mëshira. Ruso i përfytyronte bashkëtingëlloret e gjuhës së parë të njerëzve: kjo do të jetë një këngë sublime në të cilën eufonia dhe harmonia e zëvendësojnë gramatikën. Shkrimtari, i cilësdo gjuhe dhe letërsie, e përqendron në kujtesën e tij këtë trashëgimi sublime alkimike të këngës. Nganjëherë shkrimi është baras me këndimin.

Me forcimin e rolit të gramatikës e të filozofisë, gjuha humb një nga risitë thelbësore të saj burimore. Sa më tepër të përfitojnë me anë të përpikërisë dhe të saktësisë, gjuhët e humbin, nga ana tjetër, karakterin e tyre burimor; bëhen monotone, më të ftohta dhe humbin muzikalitetin. Dihet se shumica e humanistëve të shekullit XVIII mendonin se poezia buronte nga proza. Nganjëherë ajo shkruhet në trajtë kënge, në formula këndimi, duke rënduar kujtesën si shtyllën thelbësore. Gjuha bëhej instrument më i fortë. Sa më tepër i përmbahej kësaj gjëje, shkrimtari ngjallte freskinë dhe bukurinë e poezisë deri në amshim. Kështu gjuha shpëtonte nga “kanonizimi tradicional”,

fitonte ritmin e krijuesit të saj. Kjo do të thotë se për ta krijuar kuptimin e gjuhës, poeti e krijon, para së gjithash, artin e shkrimit të tij: e pasuron gjuhën, e ngjesh atë me kuptime, i jep gjak të ri atij. Pra, shprehja kryesore njerëzore buron nga poezia dhe kështu muzika dhe simbolet triumfojnë mbi kuptimet, ndërkaq kalimi prej një gjuhe në tjetrën bëhet akt i një ëndrre të madhe, pa dyshim krijuese...

* * *

I lindur në fshatin Maki, Jeronim de Rada u njoh që herët me këngën melodike popullore, e cila tek arbëreshët ishte në një rrafsh të bukur të lartë estetik, prej nga me shekuj kultivohej në mënyrë kontinuitive arti popullor në viset e Kalabrisë. Bota e tij shpirtërore ushqehet dhe brumohet që herët në frymën e këngës popullore dhe më vonë do të artikulohet e shtresohet si strukturë e qëndrueshme artistike në kryeveprën e tij, “Këngët e Milosaos”. Gjatë shkollimit në gjuhën italiane, Jeronim de Rada do të ketë mundësinë të njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me veprat kryesore antike të letërsisë greke dhe latine e më vonë edhe italiane, sidomos me veprat kryesore të periudhës së romantizmit.

Njohësit e veprës së Jeronim de Radës thonë se vepra “Këngët e Milosaos”, e botuar në vitin 1836, nuk kishte qenë vepra e tij e parë e shkruar. Që nga periudha e hershme e jetës, në përpjekjet e tij të para, ai kishte ndier shtrëngesën që i cilëson autorët me dy atdhe, ata “mes dy strukturave gjuhësore”. De Rada kishte rastisur në një “situatë bilinguale” të intertekstualitetit: mes këngëve popullore të arbëreshëve, të shkruara në gjuhë shqipe, te të cilat ruhet konstrukti integral i rudimentuar gjuhësor në gjuhën e para katër shekujve, si dhe në gjuhën italiane, në të cilën De Rada ishte shkolluar.

Kështu në një sonet, i cili paraqet krijimin e parë letrar, në moshën pesëmbëdhjetë vjeç (gjetur në një letër të cilën ai ia dërgon vëllait të tij Konstantinit, datuar më 21 qershor 1829), paralajmëron dhurëtitë dhe qëllimet e tij që të fillojë t’i shkruajë “Këngët e Milosaos” (1836). Megjithatë, para botimit të kësaj vepre, De Rada kishte shkruar në gjuhë italiane poemën “Odiseu”, qysh në vitin 1832 kur realisht ishte shkruar versioni i parë i “Këngëve të Milosaos”, si dhe disa krijime të tjera në prozë.

Shkrimi i parë në formë të sonetit është paradigmatic për veprën e mëtejme të Jeronim de Radës: ai paralajmëron se kishte për qëllim të merrej me një problematikë shumë komplekse të një bote të mbushur me mite dhe tragjikë njerëzore. Pastaj De Rada e paralajmëron “*programën e tij poetike*”, gjegjësisht “*poetikën e tij*”, të cilën më vonë do ta zgjerojë

me vepra që kanë rëndësi të veçante teorike dhe estetike. I vetëdijshëm për gjendjen komplekse në të cilën gjendej mes dy gjuhëve - gjuhës arbëreshe si gjuhë popullore shqipe në variantin arkaik, me begati shtresash poetike dhe gjuhës italiane, që i jepte mundësi të mëdha shkrimi, të kodifikuar që nga koha e Dantes, Jeronim de Rada ishte në gjurmim të zgjedhjeve të vërteta, në gjurmim të krijimit të një teksti artistik në të cilin do ta gjente botën e vet tejet të ndjeshme, emocionale dhe mendimtare, të ngjashme me atë të arbëreshëve. Forma letrare me të cilën shërbehej, soneti dhe sidomos përdorimi i vargut njëmbëdhjetërrrokësh në poemën “Odiseu”, nuk i përplotësonte ambiciet e tij kryesore poetike, prandaj ai u nis me vrap pas formave të reja, pas diçkaje origjinale, krijuese, siç u pa në veprën “Këngët e Milosaos”.

Vështirësitë e Jeronim de Radës në kohën kur e shkruan poemthin lirik “Këngët e Milosaos”, nuk janë vetëm të natyrës gjuhësore, por të një spektri më të gjerë kulturor, qytetëruar, moral dhe estetik. Vështirësitë deri në ankth të përhershëm që hasnin shkrimtarët shqiptarë por edhe shkrimtarët e tjerë ballkanas, që kishin fatin e Jeronim de Radës, që ishin shpërngulur nga mjedisi amë, Ballkani, të vendosur në një mes evropian, do të manifestohen përmes shenjave dhe rezultateve të veçanta dhe specifike. Në kohën kur Jeronim de Rada punonte me veprën “Këngët e Milosaos” (interesimi fillon që nga viti 1833), atëherë kur punonte edhe në mbledhjen e folklorit, në pjesën perëndimore të Evropës, me zgjerimin e romantizmit, u zgjua interesimi për traditat e letërsive të vendeve të cilët po çliroheshin nga zgjedha e huaj. Ky koncept gjithëevropian i romantizmit, kishte filluar me Herderin në Gjermani dhe zgjerohej edhe në vendet të tjera të Evropës Perëndimore. I frymëzuar dhe dyfish i motivuar nga cytjet ballkanike dhe evropiane, De Rada u dha pas vlerave të këngëve popullore duke zbuluar në variante të ndryshme shkëlqimet e tyre artistike dhe estetike. Jeronim de Rada ishte impresionuar sidomos nga ky thesar monumental i trashëgimisë shpirtërore arbëreshe, nga simbolet dhe mitet e lashta të trashëguara që andej Adriatikut. Koha u jepte kuptime fjalëve në substancën e tyre. Ai impresionohej sidomos nga sistemi i ngjeshur poetik i këtyre këngëve, gjë që do t’i shërbejë për t’u dhënë një strukturë finale “Këngëve të Milosaos”, por edhe atyre të mëvonshme.

Këngët gojore popullore tek arbëreshët, të njohura si “Rapsodi e një poemi arbëresh”, bartin shtresime kuptimore dhe estetike të nuancuara, begati që shpalos gjenialitetin e autorit kolektiv, intonim dhe gjakim kryesor i të cilit është ta ruajë rrjedhën bosht të narracionit, përkatësisht t’i vendosë detajet në margjina. Komponenti narrativ shpesh dialogon, mitizohet me një qëllim të vetëm që të duket rezultati final artistik: të shihet qëndresa

e etnosit arbëresh në Itali, i ballafaquar me përgjegjësitë historike, me të gjitha amplitudat gjithëpërfshirëse mitike që ka më vete. De Rada ishte i vetëdijshëm se ç'mision kishte marrë mbi krahë. Aspektin dhe “dilemat e intertekstualitetit”, De Rada në fillim duhej t'i zgjidhte në relacionin: gjuhë popullore arbëreshe dhe gjuhë shqipe. Ai ishte i detyruar që strukturimin kolektiv gjuhësor poetik ta sistemonte individualisht, gjegjësisht t'i bënte një përplotësim, një veshje. Intertekstualiteti do të shkëlqejë edhe më shumë kur De Rada do ta bart poemën në një substrat gjuhësor italian, gjegjësisht kur poema do të shkruhet italisht me një petk tërësor gjuhësor tjetër. Në të vërtetë, në kushte të tilla, De Rada do të paraqitet edhe si një kodifikues “i parakohshëm” i abetares, gramatikës dhe i gjuhës letrare tek arbëreshët, e cila, gjithsesi, është pjesë e gjuhës shqipe. Para De Radës gjendej një mision tejet delikat dhe kompleks: ai duhej të thellohej në realitetin mitik, në habitatin e bashkëvendësve të tij, t'i kuptonte dhe të gjente amplifikatorët dhe rezonatorët e vërtetë artistikë. Misioni ishte delikat dhe i ndërlikuar dhe ishte i denjë që ta përplotësonte një jetë të tij e tërë. Misioni kishte dimensionin e tij “donkishotesk”. Misioni ishte si te Dante Aligeri, i cili pavdekshmërisht e kishte kryer atë përjetë të jetëve me kryeveprën “Komedia hyjnore” në gjuhën, kulturën dhe qytetërimin italian, ose Frederiko Garsia Lorca në poezinë e tij spanjolle etj.

Po si e kishte realizuar këtë mision Jeronim de Rada në eposin e tij lirik “Këngët e Milosaos”?

Veprën e tij Jeronim de Rada e kishte mbështetur mbi bazën e sistemit të pjesëve integrale, gjegjësisht të fragmenteve që, në variantin popullor mbetën të palidhura ndërmjet tyre, pa e hequr linjën e prezantimit të ngjarjeve. Duke u mbështetur në “*aspektet e intertekstualitetit intuitiv*”, De Rada bën një montazh të veçantë të materies së pasur letrare popullore, duke u shërbyer me analogjitë intuitive dhe asosacionet si një parafytyrim i pjesëve të tekstit popullor duke kërkuar nyjat e tij të brendshme dialektike në lidhshmëritë dhe varësitë. Kuptohet, Jeronim de Rada e lexon tekstin si një lexues superior që do të thotë se ofron një aspekt përplotësues intertekstualiteti, që s'do të mund të thuhej edhe për lexuesin tradicional.

Në “Këngët e Milosaos” Jeronim de Rada nuk motivohet nga anët e veçanta efemere; për të thelbësore është ta zbulojë rrënjën e fjalës artistike. Për shkak të shumëkuptimësisë së saj semantike, mund të thuhet se De Rada hidhet në një “strategji intertekstuale”, i prek vetëm pjesët e forta strukturore duke i lënë zbrazëtitë e dukshme në rrjedhën kryesore narrative, gjegjësisht në linjën rapsodike. Gjatë leximit të thelluar të “zbrazëtirave”, gjegjësisht gjatë zbulimit të kontekstit të tyre, lidhshmërisë në integrumin kreativ, De Rada përpiqet dhe ia del të realizojë fenomenin, atëherë të panjohur

për letërsinë shqipe, të *realitetit konkret* si dhe të *realitetit fiktiv*. *Realiteti konkret* i arbëreshëve që nuk e shënon vetëm lidhshmëria sinkronike, por edhe lidhshmëria intertekstuale ndërmjet elementeve të ndryshme, sidomos të atyre të vetëdijes mitike (si dhe diakronike), poetit i shërben që ta krijojë universumin që paraqet një art të fjalës së amshueme. Kjo do të thotë se *realiteti fiktiv*, i subjektivizuar thellë në vepër, buron nga realiteti konkret arbëresh, nga ai kod mental socio-kulturor, të cilin poeti e kishte njohur me të gjitha atributet e tij.

II.

Nëse ndalemi dhe shohim historinë e letërsisë së Evropës, lehtë mund të konstatojmë se, që nga momenti i lindjes së saj, një rol shumë të rëndësishëm në të gjitha vendet evropiane, ka pasur gjuha me të cilën është shërbyer një shkrimtar i madh në krijimtarinë e vet.

Në Itali, në shekullin XIII, Dante është shembulli më i mirë i shkrimtarit që si gjuhë të vet krijuese *pati marrë gjuhën tjetër*. Dihet se Dante që shkolluar dhe në fillim, që shërbyer në shkrimet e veta me gjuhën latine, gjuhë që në atë kohë dominonte qendrat e shkollimit evropian. Por, më vonë, Dante do t'i kalonte të gjitha viset ku flitej dhe këndohej në dialektet e pastra italiane, duke u ndalur dhe duke përzgjedhur të folurën fiorentine gjatë shkrimit të kryeveprës së vet “Komedia hyjnore”, me çka ia doli t'i vinte themelet e gjuhës së sotme italiane.

Gjuha angleze formohet gjatë shekullit VIII duke u mbështetur në gjuhën gjermane, në gjuhën latine, pastaj në atë normane e skandinave. Ndërkaq, kur Giom Pushtuesi do të kurorëzohet mbret i Anglisë, gjuha angleze do të jetë e nënshtruar nga gjuha frënge. Vetëm në shekullin XIV poeti anglez Qoser do ta fusë gjuhën angleze në letërsi. E një shekull më vonë, Shekspiri do ta përjetësojë këtë gjuhë.

Në të njëjtën periudhë në Gjermani ende shkruhej latinisht. Por, njëkohësisht, prej vendi në vend bëhen përpjekje për të shkruar në variante të ndryshme të gjermanishtes. Megjithatë, letërsia gjermane realisht do të lind falë përkthimit të Biblës nga Luteri.

Në Spanjë, shkrimet e para letrare paraqiten në shekullin X në mënyrë që, brigjeve amerikane, e folmja e Kastiljes të transformohet në gjuhë spanjolle, kurse më vonë do të lulëzojë letërsia e shekullit të artë. Ky shekull do të shkëlqejë duke iu falënderuar Servantesit.

Në Francë, në shekullin XVI, Fransua I e zëvendëson gjuhën latine me gjuhën frënge nëpër dokumentet zyrtare. Po një poet tjetër, Rable, i cili kish

krijuar një kult për gjuhën greke, do t'ia ofrojë vendit të vet gjuhën frënge. Montenji, i cili në fillim shkruante vetëm latinisht, do ta ndërrojë gjuhën për të shkruar frëngjisht. Një lloj si edhe Dante, i cili do të jetë themeluesi i gjuhës së re.

III.

Mund të thuhet kushtimisht se (anti)donkishotizmi në letërsinë shqipe, ka konotime të ndryshme, por thelbi i tij shënon fatet e disa personaliteteve, jeta e të cilëve identifikohet dhe shkrihet brenda kauzës së madhe të kombit. Këto tipare të personaliteteve elitare të “antidonkishotistëve” do të vërehen tek ato figura të shquara të kombit, të cilat, duke pasur fatin të jetojnë larg trojeve shqiptare, larg vendlindjes dhe gjuhës së vet, do të përballen me raportin “konfliktuoz” ndërmjet gjuhës së vet dhe gjuhës së shkollimit dhe të ambientit në egzil - ndërmjet gjuhës së vet dhe gjuhës së tjetrit. Fati i tillë i intelektualëve dhe i krijuesve të zgjedhur shqiptarë, do ta nxisë dhe stimulojë edhe më shumë ndjenjën e donkishotizmit drejt synimit për të kapërcyer kufijtë e së mundshmes, për një artikulum efikas në shërbim të misionit madhor. Natyrisht, kur bëhet fjalë për “poetët dhe emigracionin”, për “poetët dhe egzilin”, posaçërisht të periudhës së Rilindjes Shqiptare, kryesisht mendohet për ata poetë të cilët, duke kaluar kufirin e gjuhës së lindur, e bartin në vete dhe me vete botën dhe shpirtin e të parëve, identitetin e origjinës. Kështu, poeti shqiptar në egzil, duke e transcendentuar hapësirën, e transcendenton edhe kohën. Perspektiva tjetër, ajo e bregut përtej egzilit, i mban të gjalla dhe i vë në lëvizje të vërtetat e fillimeve, tani brenda një realiteti tjetër. Gjuha e nënës, shtyllë qendrore e jetës, vjen si ngasje me porosi të pandërprera, të një natyre dhe intensiteti që nuk mund të zëvendësohet me asnjë tjetër.

Mes shkrimtarëve të mëdhenj bashkëkohorë, Xhorxh Shtajneri i vlerëson sidomos poetët që bartin nga dy apo tri struktura gjuhësore dhe te të cilët mbizotëron krijimtaria e tillë: Samuel Beketin, Horhe Luis Borgesin dhe Vladimir Nabokovin. Ajo që i madhëron këta emra, është evoluimi i universumit gjuhësor me një lehtësi të madhe. Këta bartës të egzilit gjuhësor, shprehen me një gjuhë të tretë, ndryshe nga dy të parat në të cilat shkruajnë. Kjo është gjuha, e cila, për të tjerët mbetet e paarritshme. Fati i të çrrënjësuarve për nga gjuha ka një mes shumë të rëndësishëm në kuadër të kompleksitetit drejt fatit njerëzor. Ata kanë gjasa ta transformojnë këtë fat në vokacion...

IV.

Nëse kërkohet jeta dhe vepra tipike e një autori ballkanik, i cili do ta përjetojë fatin e hidhur, por edhe famën e egzilit gjuhësor, kjo padyshim do t'i referohej poetit dhe poligrafit shqiptar Jeronim de Radës nga Maki Albanese i Kalbrisë, pranë krahinës së Shën Dhimitër Koronës, që është zemra e arbëreshëve të Italisë. Në këtë hapësirë ruhej dhe kultivohej gjuha e vjetër shqipe, të cilën shqiptarët e kishin marrë me vete nga Shqipëria dhe ndonëse të shpërngulur nga trojet e tyre pas vdekjes së Skënderbeut dhe vendosjes në brigjet e Italisë, nuk e kishin braktisur kurrë. Vendlindja e Jeronim de Radës i pranoi arbëreshët përgjithnjë, bashkë me fatet e tyre, por edhe me identitetin e tyre.

Më e shtrenjta, të cilën arbëreshët në egzil e ruanin me fanatizëm dhe dëshirë të madhe, krahas simboleve të tyre religjioze, ikonave dhe Biblës, drynave dhe pragjeve të shtëpive të tyre të braktisura, ishte gjuha e tyre, shenja e tyre dalluese e identitetit. E ruajtën këtë gjuhë larg amës së tyre si diçka të shenjtë. Përballja me fatin e këtillë dysh, mes dy gjuhëve, mes dy atdheve, *kurrë i çrrënjësor tërësisht nga atdheu i parë dhe kurrë i vendosur tërësisht në atdheun e dytë*, do të jetë karakteristika kryesore e jetës dhe veprës së Jeronim de Radës. Do t'i duhej një shqisë e veçantë e lindur, e cila s'i mungonte dhe një forcë donkishoteske, për të gjurmuar enigmën - si të ruhej, si të mbahej gjallë gjuha e nënës, krahas italishtes që imponohej me tërë forcën e vet, me logjikën e të jetuarit nën dominimin e saj të plotë. Pikërisht në mbështetje të kësaj ngasje - dhurëtie magjike, Jeronim de Rada arriti t'i mbetej stoikisht besnik gjuhës së tij amtare, gjuhës arbëreshe, të shkëputur nga burimet e saj shekuj më parë, përballë presionit të fuqishëm, evolutiv të gjuhës italiane, të gjuhës së Dantes që me veprën "Komedia hyjnore" kish krijuar substratin e italishtes së përjetshme. Jeronim de Rada besonte si një Don Kishot i vërtetë të kthimi i njëmendtë nga egzili, pikërisht përmes ruajtjes së gjuhës, përmes vazhdimësisë të gjallë të përdorimit të saj dhe vazhdimësisë së krijimtarisë poetike kolektive të popullit të vet. Besonte Jeronim de Rada gjithashtu se "kthimi" mund të ndodhte vetëm nëse mbrohej identiteti i arbëreshëve në tokë të huaj. Krijimtarinë e tij Jeronim de Rada e nis në moshë 15-vjeçare, pikërisht në gjuhën italiane, pastaj e vazhdon në gjuhën shqipe, gjegjësisht në gjuhën arbëreshe, në mënyrë që më vonë të shkruajë paralelisht shqip dhe italisht. Me të vërtetë një shembull i rrallë dhe i jashtëzakonshëm! Me gjithë faktin se gjuha shqipe tek arbëreshët kish traditë, në kohën kur De Rada e fillon krijimtarinë e tij letrare, shumica e arbëreshëve shkruanin dhe botonin në gjuhën italiane. E që të jetë paradoksi

edhe më i madh, në kohën kur De Rada shkruan në gjuhën italiane, numri i madh i shkrimtarëve shqiptarë në vend dhe jashtë shkruajnë në gjuhë të ndryshme, siç është për shembull Sami Frashëri në gjuhën arabe dhe turke, Faik Konica dhe Vaso Pasha në gjuhë frënge, kurse shumë të tjerë në gjuhën rumune, greke, italiane etj.

Në librat e parë në vargje, të shkruara në gjuhën italiane, do të hetohet tendosja e De Radës mes traditës së klasicizmit italian dhe dëshirës së tij të madhe që të mbështetet në traditat popullore të arbëreshëve. Odat e Pindarit dhe veprat e Dantes do të jenë nxitje dhe sfidë e parë e De Radës për të bredhur nëpër letërsinë klasike greke dhe italiane.

V.

Jeronim de Rada e përfytyron dhe përjeton shekullin XV arbëror si një “Mot të Madh”, kur mijëra shqiptarë kishin marrë rrugën e egzilit të përjetshëm duke kaluar detin Adriatik në pjesën e tij më jugore drejt vendit që kishte ngelur destinimi i vetëm, i hapur dhe me pasoja përherë tragjike gjatë kalimit, dramë që do të zgjasë edhe deri në ditët tona, destinimi i vetëm, i hapur, Evropa. Këto pengje shqiptare të identitetit evropian me shekuj do të dëshmojnë për udhëkryqin e vet mes Evropës dhe Azisë. Të nisur nën tryshninë e shtypjes së pushtuesve osmanë, që jetën në vendlindje ua bënte të pamundur, ata, në çaste vendimtare të netëve dhe territ, nga vatrat e tyre s’kishin ç’bartnin me vete veçse ndonjë ikonë, ndonjë amanet dhe tapi familjare, pragje të shtëpisë si simbole të *kthimit* dhe në tërësi, gjuhën shqipe, këngët, traditat dhe doket e tyre bashkë me nostalgjinë shekullore si dhe kujtesën e gjallë për *kthimin*. Ata përgjithmonë do të vendosen në viset e mbretërisë së Napolit, në viset e varfra të Italisë së Jugut. Megjithatë, pothuaj katër shekuj, kjo bartje kujtese do të jetojë thellë në shpirtin kolektiv të arbëreshëve, që të shpërthejë me një shprehje origjinale letrare në veprat e para letrare në letërsinë shqiptare të Jeronim de Radës, Gavril Darës, Zef Serembes dhe poetëve të tjerë. Ky shpërthim i madh nuk ishte vetëm rezultat i procesit të natyrshëm që kish sjellë koha, nuk ishte gjithashtu as i zgjimit italian të Rilindjes, ky ishte një shpërthim i papritur i energjisë së shtypur mendore që do të realizohet me një gjuhë të lartë poetike. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, krahas pjesëmarrjes së tyre në Rilindjen italiane, arbëreshët do t’i bartin përpjekjet e Italisë për bashkimin kombëtar çlirimtar. Në fillim ishte G. Garibaldi ai që thoshte se arbëreshët janë heronj, sepse ata i mbushnin radhët e tyre të para të luftës

kundër armiqve të Italisë, gjatë bashkimit të vendit. Megjithatë, në këtë lëvizje revolucionare në favor të bashkimit të Italisë, arbëreshët e filluan misionin e lartë të rilindjes së shqiptarëve duke u përpjekur t'i jepnin asaj një kontekst evropian. Teksti i parë kryesor letrar në gjuhën shqipe do të paraqitet në shekullin XVI. Pastaj, tek arbëreshët do të shpërthejë ideja për mbledhjen e folklorit popullor me qëllim të shpëtimit të tij dhe për ta shkruar historinë e tyre, fillimet e së cilës gjenden në luftërat e famshme të epopesë së Skënderbeut. Këngët e para të shkruara kishin pak a shumë karakter religjioz, por ato shërbenin si dëshmi e gjuhës dhe e historisë kombëtare. Fillimet e traditave do të marrin kuptim dhe përmbajtje të plotë, sidomos në shekullin XIX, gjatë apoteozave shpirtërore të Evropës, me lindjen e ideve të revolucionit borgjez francez, të ideve humaniste dhe iluministe e gjer në romantizëm. Me një vonesë të dukshme këto ide do të zgjerohen edhe në Jugun e Italisë, tek arbëreshët. Vendi i të parëve të tyre në atë periudhë bënte luftë për çlirim nga okupimi osman, luftë për çlirim dhe pavarësi kombëtare. Ky ishte sinjali historik që arbëreshët ta ringjallnin kujtesën e tyre për luftën çlirimtare të Skënderbeut para pesë shekujsh kundër të njëjtit okupator, një nxitje për çlirimin përfundimtar të vendit sidomos në aspektin shpirtëror. Në qoftë se çlirimi i *“risorxhimentos”* synonte bashkimin e Italisë në një shtet të përbashkët për zgjidhjen e problemit historik të bashkimit kombëtar, atëherë kjo para arbëreshëve parashtronte qëllimet e njëjta historike lidhur me luftën e arbëreshëve dhe Arbërisë kundër pushtuesit osman.

Zgjimi shpirtëror i arbëreshëve në kuadër të Rilindjes Kombëtare, e cila kryesisht shihej në ruajtjen e këngëve dhe dokeve të të parëve, kish një zgjerim dhe realizohej në tri drejtime kryesore: politikë, kulturë dhe letërsi. Letërsia në këtë pikëpamje zinte vendin qendror, sidomos me veprat kapitale të Jeronim de Radës, Gavril Darës së Ri dhe Zef Serembes. Fytyra qendrore e këtyre rrjedhave që u rrit në një bartës të një rilindësi të madh, ishte Jeronim de Rada.

VI.

Në vitin 1836 Jeronim de Rada e botoi poemën e tij monumentale *“Këngët e Milosaos”*, që ka rëndësi të madhe historike kulturore dhe shpirtërore për shqiptarët. Botimi i kësaj vepre epike dhe lirike s'ishte vetëm një dëshmi kapitale për vlerat e larta të poezisë shqiptare, që ishin arritur qysh në fillim të shekullit XIX, por edhe një lloj katarsisi kombëtar - dalje në Evropë. Nuk kishte kaluar shumë kohë nga deziluzionizmi ballkanik i

shqiptarëve të cilët edhe pas viktimave të shumta përjetuan shuarjen e dy shteteve feudale shqiptare, pothuaj të pavarura nga Perandoria Osmane, shtetit të Bushatllinjve në veri dhe shtetit të Ali pashë Tepelenës, në jug të Shqipërisë. Për arbëreshët, ky ishte një moment i përshtatshëm kur do të duhej përfundimisht t'i kthenin sytë nga Evropa, për çfarë u nevojiteshin dëshmi të qëndrueshme për përkatësinë e tyre qytetëruese evropiane. Prandaj arbëreshët, ata të Kozencës ndër të parët, filluan t'i mblidhnin këngët popullore nëpër fshatrat e tyre dhe më vonë t'i botonin edhe veprat e para. Lashtësia e këngëve do të dëshmonte lashtësinë antike të popullit që i kish krijuar ato.

Jeronim de Rada me një *vrull të vërtetë donkishotesk*, u nis gjurmëve të shpirtit me këngë popullore duke besuar se do të prekte dëshmitë më të thella në kohë dhe më autentike për ekzistencën e popullit të vet. I nisur me këtë qëllim, De Rada në vitin 1840 në Napoli do të botojë studimin “Zotërat e pellazgëve” në të cilin do të paraqesë edhe njëherë tezen e tij për origjinën pellazgjike të shqiptarëve, tezë e proklamuar tek arbëreshët qysh në shekullin XVII.

Është i pranishëm, pothuaj te të gjithë autorët e mëdhenj dhe klasikë të Ballkanit, një vrull donkishotesk në kërkim të rrënjëve të gjuhës, vrull i cili përfundon me një projekt dhe mision të vërtetë në drejtim të gjurmimit të tërësisë së gjuhës në të gjitha drejtimet, e në radhë të parë në përmasat kohore, gjakim drejt gjetjes së argumentit të parë për të provuar identitetin e vet kombëtar. Te De Rada ky elan donkishotesk ishte përcaktim madhor: hovi i iluzionistit do të shndërrohet në *ars-poetice* te vepra e tij jetësore “Këngët e Milosaos”. De Rada çmohet si një ndër qindra rapsodët anonimë që, përmes këngës kolektive, brez pas brezi e ruan begatinë e gjuhës, pasuron mundësitë e saj harmonike shprehëse, frymën e saj të brendshme për të qëndruar dhe për t'u bërë e përjetshme.

Jeronim de Rada e botoi eposin “Milosao” si një vepër për të gjithë, vepër që do të jetë argument i fuqishëm drejt kristalizimit të identitetit të shqiptarëve, dëshmi e ruajtjes së gjuhës së gjallë, me të cilën janë shërbyer të parët e tyre. Tre vjet pas botimit të abetares shqipe të Naum Veqilharxhit në vitin 1849, Jeronim de Rada e hapi katedrën e parë në gjuhën shqipe në kolegjin e Shën Adrianit. Duke qenë të afërt me latinitetin evropian dhe italian, arbëreshët do të arrijnë më shpejt dhe më parë se shqiptarët ballkanas, te burimet e dëshmimeve për qëndresën e organizuar të Skënderbeut, përmes autorëve të njohur evropianë nga ajo periudhë, siç ishte në radhë të parë Marin Barleti dhe vepra e tij për Skënderbeun, e cila do të ketë ndikim të madh te shumë gjenerata të autorëve evropianë për njohjen e rezistencës së

këtij udhëheqësi historik, karizmatik të shqiptarëve në shekullin XV, pastaj shkrimet e Bajronit për shqiptarët, La Martinit, Viktor Hygosë dhe shumë të tjerëve. Të gjithë këta kontribuuan drejt formimit të vizionit për njohjen e rezistencës shqiptare të shekullit XV që ishte njëherësh mbështetje bindëse për identitetin ekzistues të shqiptarëve.

Jeronim de Rada jetonte më afër Evropës sesa Ballkanit, gjegjësisht Shqipërisë së tij, më afër rrymave shpirtërore evropiane sesa përleshjeve lindore të Shqipërisë së tij. Ai ishte i lidhur shpirtërisht, si vargu i shkrimtarëve të tjerë shqiptarë rilindës të prejardhjeve të ndryshme gjeografike, që ta ruante krijimtarinë dhe qëndresën me një donkishotizëm të hapur mes estetizmit evropian dhe imperativëve pragmatike të qytetërimit shqiptar dhe Rilindjes Kombëtare. Ai bartte misionin e vërtetë donkishotesk si ish themelues i një tradite të veçantë. Mund të thuhet se në këtë traditë në një mënyrë të veçantë bashkërenditet edhe poligrafi Faik bej Konica, i cili është arsimuar pothuaj tërësisht në gjuhën frënge dhe ka lënë gjurmë në estetizmin evropian, në avangardën para-surrealiste me botimet e tij në gjuhën frënge, me pseudonimin Phyrus Bardhyli në revistën avangarde të Gijom Apolinerit “Gostia e Ezopit”, që ishte shembulli i dytë i një të kreshpëruari mes estetizmit evropian dhe Rilindjes Shqiptare. Në pozitë të njëjtë, të një donkishotizmi të llojit të vet, mes estetizmit evropian, militantizmit ballkanik dhe frymëzimit të rilindësit, do të radhiten një sërë bartësish të tjerë të Rilindjes Shqiptare. Edhe më karakteristik është rasti i poligrafit dhe enciklopedistit Sami bej Frashërit i dyzuar mes letërsisë evropiane dhe asaj ballkanike (turke dhe shqiptare). Dëshpërimi i tij donkishotesk mbase do të ishte edhe më i madh nga bartësit e tjerë të Rilindjes Shqiptare. Sami Frashëri, ndryshe nga Faik Konica, nuk e ndan identitetin e tij: njërën pjesë për përdorim evropian, kurse tjetrën për nevojat ballkanase - shqiptare. Sami Frashëri do të priret nga një lloj i veçantë donkishotesk, nga një *“iluzion produktiv”*. Duke u mbështetur në karteziqizmin evropian dhe enciklopedizmin e Didërosë, ai ëndërron që, përmes përkthimit të enciklopedive franceze si dhe përmes ndërmarrjeve leksikografike të përmasave kolosale, t’i afrojë turqit dhe shqiptarët e vet në drejtim të Evropës. Por përpjekjet e Sami Frashërit, për afrimin e shqiptarëve të tij me Evropën, do të ngelen, siç dihet, shumë më prapa nga ato të rilindësve të tjerë. Në një gjendje të njëjtë shpirtërore do të gjendet edhe Vaso Pasha, i cili do të mbërrijë në krye të hierarkisë qeveritare osmane, madje do të bëhet edhe guvernator në Liban, duke qenë, njëkohësisht, autor i disa veprave të rëndësishme në gjuhën frënge, por me përmbajtje shqiptare. Në traditat historike shqiptare dhe në përgjithësi në traditat historiografike, do të duhet një kohë më e gjatë dhe një angazhim

më i madh që veprat e këtyre poligrafëve të mëdhenj të Rilindjes shqiptare të bëhen të njohura për historiografinë dhe kulturën tonë kombëtare duke u përkthyer në gjuhën shqipe. Do të duhet, në të ardhmen, të ndërmerren nisma për studime krahasuese, për zbulimin dhe valorizimin estetik dhe kulturor të kësaj veprimtarie të madhe të rilindësve shqiptarë në gjuhë të huaja. Rasti i De Radës është i veçantë në këtë aspekt dhe meriton një kujdes të posaçëm edhe si individualitet por edhe si paradigmë kolektive.

VII.

Historia e letërsisë, njëkohësisht estetika te shqiptarët, duke pasur parasysh shtrirjen e tyre shpirtërore dhe gjeografike, paraevropiane, por edhe ballkanike, ku jetojnë, do të zhvillohet, gjithashtu, në shenjë të paradokseve. Kur bëhet fjalë për formacionet kryesore stilistike letrare në Evropë, në raport me praninë e tyre në letërsinë dhe në vlerat shpirtërore shqiptare, mund të thuhet se procesi zhvillohet rrugëve me plot pikëpyetje, thjesht përmes paradokseve. Le të përmendim me këtë rast situatën e romantizmit te shqiptarët në kohën e Jeronim de Radës. Tanimë, mes shqiptarëve nuk ekziston dilema lidhur me faktin se De Rada është nismëtar i romantizmit në letërsinë shqiptare që nga fillimi i shekullit XIX deri në fillimin e shekullit XX. Me autorin e “Milosaos” fillon edhe letërsia moderne shqiptare, e cila përmban frymën e romantizmit, por edhe të formacioneve të tjera stilistike siç janë klasicizmi, iluminizmi dhe realizmi, kuptohet edhe orientimet e tjera estetike moderne. Ndërkaq, “Këngët e Milosaos”, të mbushura me këto karakteristika, shënojnë modernitetin e poezisë shqipe. Jeronim de Rada ishte i bindur në mendimin donkishotesk se të gjitha betejat në fushën e pafund letrare fillojnë, zhvillohen dhe përfundojnë në lëmin e gjuhës. Si një Don Kishot i vërtetë i një rangu më të lartë, ai do të duhej të gjurmonte me penën si një shtizë, fjalët e vërteta në pafundësinë e mbamendjes së popullit, të ruajtura përmes fuqisë magjike të artit. Kështu, gjuhës shqipe, Jeronim de Rada duhet t’ia zbulojë frymën e re, ta lartësojë gjuhën popullore të arbëreshëve në nivel të poetikës së gjuhëve antike dhe të lashta evropiane, do të gjurmtojë shtigjeve të iluminacioneve estetike, do të gjakojë fuqinë e brendshme përjetësuese dhe do të ëndërrojë-realizojë ekspresivitetet autentike dhe origjinale.

Jeronim de Rada besonte se këngët popullore të cilat ishin ruajtur tek arbëreshët me siguri ishin fragmente të një poemthi më të gjatë, si në rastin e eposeve të Homerit. Ai ishte i bindur se burimet e vërteta të

estetikës të shqiptarët, që kultivonin traditë civilizuese të rregullt dhe në vazhdimësi, ishin të lashta. Duke e mbështetur tezën e prejardhjes antike të këtyre këngëve, De Rada do të kërkojë dëshmi për bindjet e veta, jo vetëm në shenjëzimet formale estetike, por, njëkohësisht edhe mundësi që, përmes tyre të konstituohet tërësia e procesit dhe e rrugës së identitetit të arbëreshëve. *“Nga të gjitha këngët e mbledhura”*, dëshmon De Rada, *“konstatohet se ideja themelore e totalitetit të tyre është pothuaj identike me realitetin historik...”*.

De Rada besonte se poezia popullore shqipe me vlerat e saj të mirëfillta, mund të luajë rol të madh edhe në raport me letërsinë evropiane të shekullit XIX që, siç dihet, nën ndikimin e romantizmit, ish zgjuar interesimi për folklorin e popujve të ndryshëm. De Rada mendonte (kjo shihet nga jeta dhe projekti i tij krijues), se po të arrihe të “rigjallëroje këto këngë”, pasi të mblidheshin, të sistematizoheshin dhe botoheshin, pasi të merrnin formën e një tërësie dhe plotësie estetike, ato me siguri do ta tërhiqnin edhe vëmendjen e Evropës romantike. Por, sipas De Radës, veç rëndësisë së padyshimtë evropiane, këto këngë kishin një rëndësi të paçmuar për popullin në dy drejtime: si monumente që dëshmojnë të kaluarën e lavdishme historike të popullit, por edhe si një nxitje për një edukim patriotik të popullit. Këto këngë, sipas De Radës, do të duhej, përmes ndriçimit të fytyrës së Skënderbeut, të shpjegojnë dhe të analizojnë disa të vërteta dhe kundërthënie të eposit shqiptar në prag të “fatit osman”. Por, mbi të gjitha, këto këngë mbeten dokumente autentike për gjuhën e lashtë dhe vitale shqipe, si këngë të paramenduara, të thjeshta, por edhe këngë të një misioni të rëndësishëm historik...

VIII.

Në vitet tridhjetë të shekullit XIX, me kryeveprën e tij “Këngët e Milosaos”, Jeronim de Rada shënoi një epokë të re në letërsinë shqipe: e shpalli periudhën e poezisë moderne në frymën e romantizmit letrar evropian. Ky krijim poetik monumental, që do të vazhdojë të jetojë dhe të shkëlqejë në shpirtin shqiptar, e bëri të pavdekshme gjuhën arbëreshe në të cilën është shkruar.

Secili popull, shkruante De Rada në librin e tij “Parimet e estetikës”, në shoqërim me këngën e vet, bashkudhëton nëpër kohë, duke e ruajtur plotësinë e vet, fizionominë e identitetit. Nuk dihet nëse Jeronim de Rada kishte njohuri për faktin se, këngët e ruajtura arbëreshe kishin apo nuk kishin

në vete jehonën e muzikës së lashtësisë antike pellazgjike. De Rada kishte bindjen se muzikaliteti tingëllues i këngës arbëreshe për Skënderbeun dhe epokën e tij, edhe mund të ishte një inspirim i largët, i bartur nga thellësitë antike deri në ditët tona. Ky muzikalitet krejt i veçantë dhe i ndryshëm për nga forma, degëzohet në dy pole të cilat harmonizohen edhe me poezinë e sotme shqipe: në tetërrokëshin epik dhe në njëmbëdhjetërrokëshin lirik. Kjo poezi nuk shpreh aspirata që trembet t’i shpalosë, ajo nuk shpreh pasione, por është krijuar me tone reale, konkrete, me rigorozitet, që të përkujtojnë lëvizjen harmonike të valsit. Ajo me siguri ka mbështetje mbi një bazë muzikore ku zhvillohet dhe madhërohet narracioni epik duke zgjuar besimin në shpirt, gëzimin dhe frymëzimin heroik. Ajo shënon edhe melodinë e një ndjenje thuajse të pakapshme, e që shtrihet pastaj si vaje, por edhe si tinguj hareje të shpirtit. Në këto këngë, ka aq emocione depërtuese sa në çaste ke ndjesinë se i prek të gjalla bukuritë e shpirtit gjatë shekujve. Shtresimi i epokave në tingujt e melosit simbolizon harmoninë dhe ligjshmërinë e gjërave në hapësirë, gjithnjë në përkrahje të tingujve përfundon Jeronim de Rada. Në laboratorin poetik të De Radës fjala buron nga thellësitë e oqeanit të kohës, e freskët dhe e ripërtërirë, e lirë nga ndikimet dhe shtrëngesat e jashtme. Me gjithë faktin se regjistri i fjalës është i varfër, sidomos në raport me universin që e rrethon, ajo disponon të gjitha fuqitë e brendshme shprehëse, përkatësisht fuqinë e brendshme shpërthyesë për ta kapur tërësisht botën shpirtërore me të gjitha situatat dhe sfidat e paparashikueshme të shpirtit dhe mendjes, edhe gjatë çasteve më të ndjeshme dhe më të nuancuara njerëzore. Fjala në poezinë e De Radës i prek dridhjet më të holla të zërit, të cilat burojnë brenda dhe jashtë shpirtit të Milosaos dhe të heroit tjetër kryesor të poemës, Rinës, në një mënyrë që ajo e artikulon kujtesën kolektive të arbëreshëve, të shkruara në këtë vepër si dy jehona të një sinteze letrare, artikuluar në një vepër monumentale siç është “Këngët e Milosaos”. Memorien kolektive De Rada nuk do ta thithë nga librat, ai e ka të brendshme, të lindur, e ka në gjak, në fjalën dhe këngën arbëreshe, në vatrën e fshatit arbëresh. Si një krijues i madh, ai në mënyrë shumë të bukur ndien se pa gjallërimin e kujtesës kolektive humbet dhe zhduket jeta e njeriut: kujtesa e gjallë dhe e rigjallëruar e bën njeriun njeri, ia zbulon horizontin e lëvizjes, e bën të kapshëm dhe të kuptueshëm.

* * *

Cila është gjeneza, cilat janë motivet e muzës së poetit në perceptimin dhe krijimin e kësaj vepre të madhe? Le të ndalemi për një çast në kohën kur De Rada ishte njëzet vjeç (në vitin 1834), në kohën kur ishte student në

universitetin e Napolit, dhe kur me një rast gjatë udhëtimit në fshat, zbulon magjinë e dashurisë, bartjen e lumtur të ndjenjave erotike në poezi dhe fillon ta ndajë gëzimin e tij jetësor me universin njerëzor. Dhe paralelisht me këtë zbulim të brendshëm, poetit të ri arbëresh shekujt e rrënjësor në këto anë, ia zbulojnë tashmë ndjenjën për brigjet e vizatuara të stërgjyshërve nga ana tjetër e detit, për prejardhjen e tij. Kjo ndjenjë e ndrydhur e brufulluar si një trashëgimi pa e ditur as vetë pse, gumëzhin në ndërrijen e tij si një jehonë e largët, si një dhembje, mall dhe pikëllim, si plagë e braktisjes së vendit të lindjes, si një jehonë e largët, e tërthortë, e një ndjenje faji, si etje e pashuar nëpër kohëra, si një dridhmë e thellë në vete për pastrim shpirtëror. Të gjitha këto gjendje, ndjenja zgjimi dhe shpërthimi, këto plagë të shtresuara nëpër mote, piqen, brumosen me fjalë të vërteta qëndrese. Dhe kështu De Rada, poeti i një formati të madh, krahas gjurmimit dhe njohjes së bukurisë të madhe të Rinës, e përjeton edhe ndjenjën e madhe të gjetjes së gurrës të identitetit burimor. Rina i paraqitet si një shkëndijë që ia rrëmben shpirtin, ndërsa zgjimin arbëresh e kishte të tulatur në gjak.

Që para këtij rizgjimi, poeti kishte bërë disa përpjekje poetike, të shkruara në gjuhë italiane, të cilat do të jenë trokëllimat e para për t'u hapur dera e madhe dhe për të hyrë triumfalisht në panteonin e amshuar të poezisë shqipe. Kështu, studenti De Rada, me njëzet vjetët e jetës së tij, me dashurinë e madhe për Rinën, me fatumin arbëresh më vete, me një regjistër të vogël fjalësh shqipe, por me një frymëzim të madh do ta krijojë kryeveprën "Milosao".

IX.

Dhe kështu, në spektrin e rrethanave, Jeronim de Rada do ta artikulojë universin Milosao. Duke u gjetur në krahët e dashurisë së Rinës dhe të agimit arbëresh, ai do të shkruajë një vepër të përkryer poetike, në dritën dhe në frymën e artikulimit mjeshhtëror të dy zgjimeve në një, në frymën e idealizmit donkishotesk. I drejtuar nga vizioni harmonik dhe i përsosur, Milosao do ta ndjekë fatin e tij të dashurisë brenda kohës së personazhit të "Motit të Madh", brenda hapësirës dhe gjirit të Shkodrës. Si e këtillë, si gjurmim këmbëngulës, si gjurmim pas harmonisë së brendshme, do të zhvillohet dhe kuptimësohet odisejada, drama e Milosaos, ndërgjegjja e të cilit, në çaste të caktuara, gjatë fragmenteve të qeta dhe të lumtura nga jeta e tij familjare, i lumtur në krahët e Rinës, do të ngarkohet me kërcënimet e Nënës së Madhe, pse djali i saj nuk i është kushtuar plotësisht Rilindjes

Arbëreshe, artikuluar si një zë e jehonë e thellë që simbolizon dhe aludon thirrjen nga perspektiva e Motit të Madh. Vetëm nga fundi i jetës, vetëm kur fati do ta braktisë nga më të afërmit, familja, djali dhe gruaja, Milosao me ndjenjën e largët të fajit dhe të përgjërimit, do t'i dorëzohet plotësisht thirrjes së dheut të vet, në mbrojtje të tij.

* * *

Në kuadër të një fragmenti kohor nga jeta e Milosaos, përplot ngjarje të shumta, De Rada, do ta krijojë universin e quajtur *Milosao*, i cili ngjet si një univers i ekzistencës njerëzore, univers i shënjuar me fillimin dhe fundin e tij si dhe me të gjitha fazat e tij të ekzistencës njerëzore. Kurse ai, Milosao, e nis atë fragment të jetës së vet me daljen në rrugë të madhe drejt pjekurisë, me zbulimin e parajsës së quajtur dashuri, me zgjimin, përqaftimin e rrënjëve, i dehur nga lumturia e jetës pranë vatrës familjare, në krahët e jetës që, më në fund rrjedh me të gjitha fazat e saj, me gëzimet dhe dëshpërimet, me rëniet e ngritjet, me jetën dhe vdekjen, e cila vjen fatale dhe e pamëshirshme. Faqet e lumturisë dhe të tragjedisë do ta përcjellin dhe karakterizojnë ligjërimin e jetës së heroit. Maturanti i sapodiplomuar, romantiku i flaktë që ecën rrugës drejt “Motit të Madh”, me zërin e gjeniut, çfarë ishte, do të hetojë një tjetër rrugë të heroit si një hapërim drejt lartësive parajsore, por me fat tragjik, me një fat të mbylljes së harkut kohor të heroit i cili qëndron në lartësi të një urtie, ashtu si mendimtarët e mëdhenj.

Kënga e tridhjetë, përfundimi i veprës “Këngët e Milosaos”, ma përkujtoi - gjatë rileximit para disa ditëve të romanit “Lufta dhe Paqja” të Tolstoit - fundin e jetës së Knjaz Andreut: i plagosur për vdekje në luftën e Austerlicit, i shtrirë pranë një druri, me sy të ngulitur në qiell, mbi kokë sheh një re që lëviz, që ecën diku, pamje kjo që për të, për Andreun, bëhet gjëja më e rëndësishme në botë. Në çast i shndërrohen të gjitha gjërat e botës, të gjitha fitoret dhe humbjet e tij, fitoret dhe humbjet e Bonapartit, e gjithë bota në asgjë, në një hiç; vetëm ajo re e vogël në qiell i bëhet kaq shumë e rëndësishme, më e rëndësishmja gjë në jetë. Le të ndalemi vetëm në vargjet e fundit të Milosaos, i cili, i shtrirë jep shpirt duke kërkuar nga bashkëluftëtarët t’ia hapin pamjen e horizontit:

*Hapeni shatorin
O ushtarë ta shoh Shkodrën
Dhe timen motër të kërrusur në dritare...
Atje edhe një ditë nuk do të zgjohem
Që luleve kur era i tund...*

Vetëm poezia ka fuqinë ta krijojë harmoninë, ta vërë atë në një radhë me ekzistencën njerëzore përkohësinë e vet, qëndresën, të bukurën dhe tragjikën. Vetëm ajo mund t'i zhvillojë gjallërisht të gjitha krahët e ekzistencës, të na sjellë përqendrimin e qetë. Të zhveshura krejtësisht nga syri zhbirues i poezisë, dy personazhet, si dy anë të skajshme të ekzistencës së qenies së njeriut, atë as e dëshpërojnë, as nuk e shqetësojnë, as e nënvlerësojnë. Përkundrazi, e mobilizojnë e përgatisin, e falënderojnë, e madhërojnë. Si lexues besoj se kemi këtë ndjenjë kur arrijmë fundin e pjesës së lumtur, por dhe tragjike të jetës së Milosaos...

X.

Jeronim de Rada ishte i detyruar që pjesën arbëreshe të “statusit donkishotesk” të letërsisë shqipe, ta mbronte shumëfish në sfera të ndryshme konfliktuale. Me “vrull donkishotesk” u fut në gjuhën e verifikuar të gjuhës poetike arbëreshe, sidomos te Milosao, por edhe në eposet e tjera, siç janë “Serafina Topia” dhe “Skënderbeu i pafanë”, përkundër mungesës së gjuhës së kodifikuar shqipe. Ai krijoi një “kodificient” të gjuhës poetike me të gjitha shenjat. Me “shpërthimin donkishotesk” De Rada nxitonte pas gjurmëve burimore të poetikës së Milosaos së tij, i mbërthyer ndërmjet këngëve italiane të renesancës dhe këngëve arbëreshe, të krijuara në të njëjtin truall, por me tradita të ndryshme. Në studimin e tij “Disa shënime të poezisë së De Radës”, Eqrem Çabej, mes të tjerash, thotë: “Mendoj se në disa figura dhe motive, këngët e tij bartin shenjat e këngëve të poezive italiane të renesancës. Por këtu bie në sy edhe një ndikim që deri sot nuk është vërejtur. Që të përplotësohen skenat e luftës me figurat mashkullore dhe femërore të orientit, të cilat duhej t'u kundërshtohen otomanëve, poetit i duhej ideja që të marrë disa motive dhe emra të poezisë klasike të Indisë”.

Ky dhe një varg shembujsh të tjerë tregojnë se De Rada i kishte pastruar hesapet me faktin se romantizmi evropian, i dalë nga një kontekst tjetër qytetëruar dhe historik dhe që në Lindje gjurmonte elemente të ekzotizmit dhe të folklorit, evoluime epike, u shmangej ligjeve të klasicizmit. Për arbëreshët dhe në përgjithësi për shqiptarët, orienti me të cilin realisht jetonin, kishte një kuptim fare tjetër. Naim Frashëri dhe sidomos Sami Frashëri, i zbulonin një kuptim dhe përmbajtje fare tjetër orientit, prandaj ai edhe reflektohej ndryshe në veprat e tyre letrare, shkencore dhe kombëtare.

Si shkrimtarëve të tjerë shqiptarë të Rilindjes, edhe poetëve arbëreshë nuk u shkoi për dore të merrnin dhe të përfitonin kushedi sa nga romantizmi

evropian, në radhë të parë, për shkak se atdheu i të parëve të tyre gjendej nën pushtimin e Perandorisë Osmane. Ndërkaq, De Rada, si një Don Kishot, besonte se ideali romantik i një drejtimi tjetër do ta dëshmonte identitetin autentik dhe krijimtarinë popullore të arbëreshëve të vet. Në atë kontekst, mbase edhe mund të thuhet se, në njëfarë dore, De Rada kremtonte “fitoren poetike” mbi romantikët evropianë, të cilët për qëllimet e tyre në Lindje kërkonin shembuj të trimërisë, të ekzotikës! Me këtë rast meriton të përmendet qëndrimi i kolosit të letërsisë franceze dhe evropiane, Lamartinit ndaj veprës poetike të Jeronim de Radës. Lamartini pat mundësinë ta lexonte italisht versionin e epove të De Radës “Këngët e Milosaos” dhe “Serafina Topia” para udhëtimit të tij në Itali dhe gjatë qëndrimit në ishullin Iskia pranë Napolit. Poeti i madh francez pas leximit të këtyre librave, më 8 shtator të vitit 1844, nga Iskia, do t’i shkruajë De Radës:

“Zotëri,

më gëzon fakti i vëllazërimit poetik ndërmjet jush dhe meje. Poezia vjen nga brigjet tuaja dhe atje duhet të kthehet. Unë edhe nuk mendoj për diçka tjetër pos se po e parandiej lirinë dhe rindërtimin e Shqipërisë. Ju më bëtë një nder të madh. Më vjen shumë keq për rrethanat që më pengojnë të takohemi dhe ju lus t’i pranoni përshëndetjet e mia, falënderimin tim dhe dëshirat e mia më të mira.”

XI.

Edhe pse Jeronim de Rada e kishte drejtuar tërë gjenialitetin e tij poetik nga *rikonstruktimi* i këngëve të vjetra epike në gjuhën e lashtë arbëreshe, gjuhë e cila kishte vazhdimësi shumëshekullore, në të njëjtën kohë gjakonte që, duke bërë rikrijimin artistik të tyre, të dëshmojë edhe vitalitetin, aftësinë shprehëse të gjuhës “së rilindur”. Veprat e tij i shkruante edhe në gjuhë italiane me çka e krijonte një komunikim të hapur me autorët e atëhershëm evropianë. Një karakter dhe synim të këtillë e kishte edhe komunikimi me kolosin e romantizmit evropian, Lamartini. Pas episodit epistolar, ndodhi edhe kontakti, por për këtë nuk ka të dhëna të shkruara. Pas variantit italian të “Milosaos”, “Serafina Topisë” dhe veprave të tjera të De Radës, do të reagojnë edhe autorë të tjerë të rëndësishëm evropianë. Të theksojmë reagimin e Frederik Mistralit, i cili, pas leximit të krijimeve të tij, ndër të tjera, i shkruante De Radës:

“Krijimet tuaja janë plot magji, freski dhe shqetësim ungjillor. Agimi i kaltër buzëqesh, çfarë pamje e çuditshme! Po kjo është aroma e idileve

biblike dhe mushti i gjuhëve “të virgjëra”... gjersa gjuhët e mëdha zyrtare kanë një numër të madh lexuesish të veprave të atyre që shkruajnë në këtë gjuhë, gjuhët natyrore i ruajnë burimet e poezisë së vërtetë. Duhet të jeni shumë të lumtur që fati ua solli fitoren: t’i shkruani psalmet e Shqipërisë suaj të dashur. Këngët tuaja përplot freski, janë monumente të atdheut tuaj...”

* * *

Jeronim de Rada kishte qenë i detyruar të ishte Don Kishot i lumtur. Me shigjetën e tij si penë, ai arrin ta shpojë tokën në vendin e qëlluar dhe t’i ngjallë burimet e bukurisë së gjuhës së vjetër arbëreshe. Ai me këtë i bën për vete dhe i grish magët evropianë të romantizmit për mirënjohje, siç janë Lamartini dhe Mistrali. Më kujtohet një metaforë e poetit bashkëkohor francez Zhan Zhak Ruso, i cili, duke e zbuluar poezinë maqedonase, në një parathënie antologjike, do të theksojë se *i lakmon poetët maqedonas*, gjegjësisht poetët e gjuhëve të reja, *poezitë e tyre të cilat nuk i kanë shterur të gjitha mundësitë e metaforave*.

Frederik Mistrali, gjatë leximit të poemthit “Këngët e Milosaos” të De Radës, “ia qëllon” një çështjeje esenciale: *çështjes së gjuhëve të natyrshme*, që ka të bëjë me fuqinë e tyre burimore poetike kundruall “gjuhëve zyrtare”, gjegjësisht gjuhëve të standardizuara, të cilat më vonë etablohen edhe si gjuhë ndërkombëtare, universale, përfshirë këtu edhe gjuhët ndihmëse, artificiale. Dilema e autorëve shqiptarë, sidomos e poetëve arbëreshë, për gjuhën e tyre amtare, arbërishten, tanimë arkaike, e gjendur brenda një izolimi pothuaj të përhershëm, apo për gjuhën italiane, e cila i rrethon dhe e cila do të vihet në shërbim të krijimtarisë nga vetë Jeronim de Rada, në mënyrë analoge do ta motivojë Faik Konicën në gjurmimet e tij estetike teoriko-letrare dhe linguistike, sidomos në esenë për gjuhët natyrore dhe gjuhët e sendërtuara, të shkruar dhe botuar në gjuhë frënge (për të cilën bëhet fjalë në mënyrë të veçantë në këtë libër) dhe që në kohën e vet do t’ia tërheqë vëmendjen Giom Apolinerit dhe Remi de Gurmonit, ky i fundit i njohur edhe si “papa i simbolizmit”, do të vazhdojë të jetë dhembje e përhershme. Teza e Frederik Mistralit për fuqinë burimore poetike të gjuhëve natyrore, pas leximit të “Milosaos”, në fakt do të jetë premisë nismëtare për Faik Konicën, e theksuar në një kontekst tjetër kohor dhe hapësinor, përkrahur nga Apolineri dhe Remi de Gurmoni. Kjo do të jetë teza për superioritetin e gjuhëve natyrore ndaj gjuhëve artificiale. Pikërisht këtu do të mbështetet kontinuiteti lidhur me parimet estetike njëshekullore mes Jeronim de Radës dhe Faik Konicës... Që të dy janë të njohur për nga dysia e estetizmit

evropian dhe e “militantizmit estetik ballkanik” (imperativë rilindëse për kodifikimin e alfabetit, gramatikës dhe gjuhës amtare shqipe). Jeronim de Rada, ndryshe nga Faik Konica, ndjek rrugën dhe qëndrimin e vet ndaj “estetizmit evropian” dhe dilemat e tij janë të një tipi të hapur. Ai nuk e “fsheh fytyrën evropiane” me pseudonim sikundër Faik Konica, i cili, si një Janus, do ta ketë një pseudonim për “estetizmin evropian” (Pyrrus Bardhyli, Frank Spiroberg etj.) kurse përballë “faqes ballkanike” do të shfaqet me emrin e tij të vërtetë, Faik Konica. Ndërsa nisma dhe qëllimi kryesor i *euro ballkanizmit* të tyre do të jetë gjuha shqipe, gjurmimi i gjenezës së saj, mbledhja e trashëgimisë folklorike, vendosja e alfabetit, norma kyç e kodifikimit.

Jeronim de Rada, edhe pse i ngulur në tokën italiane relativisht herët, pas kthjellimit të iluzionit për italishten si gjuhë definitive e vokacionit të tij poetik, do të përcaktohet për variantin arkaik të arbërishtes, gjegjësisht dialektin shqip të stërgjyshërve të tij që kish ngelur gjuhë komunikimi me bashkëvendësit në Itali. Botimet e tij të para poetike si edhe traktatet, studimet, esetë do të jenë italisht. Një ditë kur ai, si një Don Kishot “i zgjuar” do të deziluzionohet dhe do të heqë dorë nga shkrimi në gjuhën e Dantes e të Petrarckës, peshën e gjuhës italiane do ta vërë në shërbim të gjuhës së vet arbëreshe. Në të dhe për të, ai do t’i bëjë deri në fund të jetës të gjitha “betejat estetike”. Është i njohur refreni i tij në relacion me italishten, që e vëren Faik Konica *Questa modiasima non era mia nativa* (kjo gjuhë e mallkuar nuk është gjuha ime). Megjithatë, pothuajse nuk ekziston shembull tjetër estetik nga letërsia evropiane, si ai i paralelizmit gjuhësor të Jeronim de Radës në shkrimin e eposeve të tij klasike me një përkthim në gjuhë italiane...

XII.

Ndërkaq, ky “dyzim i braktisur”, gjegjësisht përcaktimi definitiv i De Radës për t’i shërbyer tërë jetës postulatit poetik arbëresh, duke gjakuar tërësinë dhe vazhdimësinë gjuhësore, historike e kulturore, letrare dhe qytetëruese të shqipes, sigurisht që kërkon një hulumtim integral, nga një perspektivë krahasimore studimore. Në këtë kontekst, i duhet kushtuar vëmendje të veçantë esesë “Parimet e estetikës”, më të rëndësishmit në këtë fushë të Jeronim de Radës, botuar në Napoli dhe e përkthyer përherë të parë në gjuhën shqipe nga profesor Alfred Uçi, (Globus R., Tiranë, 2003) me rastin e 100-vjetorit të shkrimtarit (28.02.2003).

Veprën “Parimet e estetikës” mund ta konsiderojmë edhe si një lloj testamenti eklektik i tipik donkishotesk i autorit, i kushtëzuar nga dualiteti i tij i pandërprerë euroarbëresh, gjegjësisht euroshqiptar dhe të qenit dysh i botës shqiptare mes dy botëve dhe civilizimeve, me shkallë evoluimi të ndryshme, por me prirje të theksuar drejt qendrës evropiane të vlerave. Dhe jo vetëm kaq: vepra “Parimet e estetikës” e De Radës i bart idetë dhe shqetësimet autentike, iluzionet, thellimet teoriko-estetike dhe filozofike të arbëreshit të madh. De Rada e shkruante “Testamentin e tij estetik” duke iu drejtuar arbëreshëve ose italo-shqiptarëve, siç i quanin, duke pasur parasysh edhe lexuesin italian dhe evropian, por me sytë e kthyer drejt atdheut të vet të humbur, përtej detit Adriatik.

Jeronim de Rada, tërë kozmopolitizmin dhe mediteranizmin antik, do ta derdhë në librin e tij “Parimet e estetikës”, vepër që është mbështetur në përvojat më të qëndrueshme dhe më të njohura të estetikës, artit dhe letërsisë botërore. Një vlerë të veçantë, të dorës së parë, kjo vepër me karakter teoriko-estetik, me depërtim të thellë brenda shtresimeve të mendimit filozofik evropian, ka edhe për funksionin dhe misionin e theksuar pragmatik, të kërkojë zgjidhje të çështjeve themelore nga jeta e arbëreshëve, para së gjithave në drejtim të identitetit, gjuhës, lashtësisë, përkatësisht të dëshmojë përkatësinë arbëreshe brenda familjes së madhe evropiane, afërsinë e saj me kulturën dhe lashtësinë antike evropiane.

“Parimet e estetikës”, siç e thamë edhe më sipër, është shkruar në gjuhën italiane, në një stil të veçantë, individual, që largohet nga gjuha letrare italiane e shekullit XIX. Libri është shkruar në mesin e shekullit XIX, në periudhën kur estetika ende nuk ishte diferencuar nga filozofia dhe përfshinte më shumë fenomene, kështu që problemet e vërteta estetike, që zënë vend kryesor në këtë vepër, janë vendosur në pjesën e tretë të librit. Në pjesën e parë janë vendosur fragmente që trajtojnë disa nga çështjet filozofike, siç është përcaktimi i shpirtit, i intelektit, i emocioneve. Më pas autori tregon interes për dallimet mes fenomeneve shpirtërore të njeriut dhe pjesës tjetër të botës së gjallë. Ai polemizon me botëkuptimet e ndryshme estetike dhe doktrinat e ndryshme nga kjo fushë. Në pjesën e dytë të librit, autori përqendrohet në fushën e bujqësisë dhe flet për të mirat nga puna fizike. Jeronim de Rada mbron tezën se, arma dhe shpirti i militarizmit, që mbizotëronin asaj kohe në Evropë dhe që ishin drejtuar kundër lirisë dhe përparimit të popujve, megjithatë, nuk mund t’i bënin të përjetshëm regjimet tiranike.

Pjesa e tretë e librit, më e rëndësishmja, trajton probleme të ndryshme, por në pjesën e saj dërmuese, shtrohen çështje të estetikës. Në fillim trajtohen

llojet e ndryshme të bukurisë, ndërsa më pas i identifikon ato përmes aspekteve të ndryshme dhe shenjzimeve morale. Ajo që duhet veçuar në këtë pjesë të librit, është analiza që De Rada i bën ndjenjës së patriotizmit, të cilën ai e çmon si manifest të bukurisë, të përsosmërisë.

Me rëndësi të posaçme është edhe pjesa e katërt e veprës, në të cilën autori merr të analizojë disa aspekte gnoseologjike, siç janë njohja racionale, e vërteta, sidomos raporti mes mendimit dhe gjuhës, pjesë që veçanërisht tërheq vëmendjen tonë. Më pas, De Rada synon t'i lidhë premisat gnoseologjike me ato estetike dhe pedagogjike. Në këtë rrafsh De Rada e thekson rolin e arsimimit, pedagogjisë dhe në përgjithësi atë të ngritjes së vetëdijes dhe shkollimit të arbëreshëve, duke u ndalur edhe në disa probleme pragmatike të kohës, siç janë: arsimimi dhe shteti. Ndërkaq, në strukturën e këtij kapitulli, vëmendja kryesore përqendrohet në pjesën që i kushtohet lingistikës, rolit të gjuhës, si dhe zgjerimit të njohurive dhe ndjenjave patriotike. Duke i prezantuar vlerat e gjuhës shqipe dhe rëndësinë që ka njohja e saj, autori ndalet në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Jeronim de Rada në "Estetikën" e vet bën fjalë dhe për gazetarinë, për profesione të ndryshme, por edhe për çështje të shkencës së asaj kohe, që, në fund fare, t'i kthehet përsëri çështjeve të estetikës dhe artit. Thënë shkurtimisht, Jeronim de Rada në veprën "Parimet e estetikës" trajton por edhe vihet në kërkim të çështjeve thelbore të fenomenit art përgjithësisht... Ai gjurmon pas thelbit të fenomenit në art, merret me teorinë e zhanreve të artit, brenda të cilit e përfshin edhe temën e dashurisë.

XIII.

Kujdes të veçantë meriton kapitulli i shtatë i pjesës së katërt i veprës "Parime të estetikës" së Jeronim de Radës, edhe pse Don Kishoti shqiptar nga Kalabria nuk e fsheh synimin kryesor - ta shpëtojë nga harresa gjuhën e stërgjyshërve. Prandaj, për De Radën:

"Fillimi dhe baza e çdo dijeje, është gjuha, e cila njëkohësisht e mban në jetë identitetin e vlershëm të popujve! Sepse, shtetet mund të përmbysen dhe të zhduken, shtetet e disa fiseve mund të merren nga fise të tjera, të cilat vijnë më vonë, por gjuha mbetet më kryesorja që një popull e bën të njohur, pa marrë parasysh brigjet në të cilët i ka hedhur dallga e jetës."

Interesimi i njeriut për prejardhjen dhe forcën e gjuhës daton që nga kohët më të lashta. Nevoja për gjuhën me kalimin e kohës, për njerëzit, sidomos për shkrimtarët, te krijuesit e fjalës artistike, shndërrohet në një

obsesion. Në rastin e Jeronim de Radës ky raport i gjuhës arrin shenjat e një “obsesioni donkishotesk”, për të cilën ka aq shumë dëshmi në librin e tij “Parime të estetikës”. Që nga momenti kur përqendrohet me pasion në domethënien dhe rëndësinë e këngëve të vendlindjes, duke i trajtuar si “rojtarë të dëshmisë së pavdekshme të jetës sonë të veçantë”, De Rada do të ndalet sidomos në pyetjen: “Çka shpreh gjuha shqipe nga shpirti ynë dhe pse ka rëndësi të veçantë për të gjithë arbëreshët posaçërisht, për njerëzit e shpërngulur dhe, çka duhet të çmohet si faktor kryesor i cili na lidh dhe na largon si fis, i respektuar mes tjerëve?”

Në kërkim të përgjigjeve të mundshme të këtyre pyetjeve dhe dilemave, Jeronim de Rada veçon të folurit - gjuhën pra:

Si një pasqyrë e vullnetit dhe mendimit të njeriut që e dallon nga klithmat e kafshëve. Prandaj, - thekson De Rada, me gjuhën e folur zënë rrënjët e familjes së njeriut ndërsa njeriu, që të ecë përpara, ka krijuar gjuhën dhe historinë dhe prandaj gjuhët jo vetëm që janë mjete për komunikim në shoqëri, por rrënjët e tij janë më të thella nga se sa mendohet. Gjuha pra, është dhe mbetet aftësi e njerëzimit për të shprehur idetë e veta të shenjta. Duke besuar se krijimtaria është akt qiellor, e njëkohësisht edhe sizifian, jo vetëm i të zgjedhurve, por i një bashkësie të tërë njerëzore dhe nëse sot, - thekson më tej Jeronim de Rada, asnjë gjuhë, me të gjitha fjalët e veta të zgjedhura, nuk arrin ta shprehë tërë plotësinë e të gjitha dukurive të qenies, megjithatë nuk duhet të nxirren përfundime se gjuhët janë krijime të papërsosura të njeriut dhe se, një ditë ato nuk do të jenë në gjendje të shprehin një majë të papushtuar të qenies së tyre të tërësishme, me çfarë, Jeronim de Rada, si mendimtar përmasash të mëdha, e kishte të qartë se mundësitë e gjuhës, edhe të asaj më të pasur e më të përpunuar, janë të kufizuara karshi ëndrrës dhe botës shpirtërore të njeriut, njësoj, siç më pas do ta shprehet edhe Naim Frashëri i madh përmes vargjeve monumentale:

*E ku shkruhen në kartë
Fjalët e gjuhës së zjarhtë...*

Kështu, pra, mendon Jeronim de Rada se, pa marrë parasysh që gjuhët vazhdimisht pasurohen, kurrë nuk arrijnë t’i prekin thellësitë e pafundme të shpirtit dhe të mendjes së njeriut. Kështu, për shembull, sipas Homerit, gjuha greke, kurse sipas Dantes, gjuha italiane, janë gjuhët që u bënë më të pasura, edhe pse, kjo pasuri, sipas Jeronim de Radës “nuk e shtoi sasinë e energjisë që kishin këto gjuhë gjatë lindjes së tyre”. Kjo, s’ka dyshim se është rezultat i “papërsosshmërisë” së njeriut, e megjithatë, njësia e gjuhës mbetet fakti

më stoik: ajo është shprehje e qenies dhe asgjë më tepër. Pikëpamjen e tillë De Rada e shpreh edhe në gramatikën e tij. Gjithashtu, këtu e zbulon edhe këtë unitet, me anën e së cilës synon të japë zhvillimin unik të shpirtit. Me këto dy fenomene, shpjegohet fakti se njerëz me gjuhë të ndryshme mund të kuptohen mes njëri-tjetrit. Larmia e tingujve të gjuhëve të ndryshme, është refleksi i karakterit të universumit të pafund të gjuhës, të cilën, një gjuhë e vetme, bashkë me shpirtin dhe jetën e një populli të vetëm, nuk mund ta përfshijë tërësisht. Yjet, sipas shembullit që e nxjerr Jeronim de Rada, shkëlqejnë me një dritë të përhershme dhe të ndërprerë, e që shpaloset përmes fjalës latine “stella”, por ekziston edhe një tjetër dritë, më e madhe dhe e pandërprerë, që helenët e shprehnin me fjalën “astir”. Në agim, drita e yjeve zhduket, ndërkaq yjet prapë janë atje në të njëjtin vend. Ky lloj i dritës i shkon më mirë fjalës shqipe “iill” (ylli). “Ndërkaq”, - thotë Jeronim de Rada, “*edhe gjuha më e madhe ose më e dobët, në mesin e të tjerave, nuk do të zhduket sikundër që, secili yll, edhe më i vogli, që mbase edhe nuk duket, e ruan vendin e vet në qiell...*”

XIV.

Rilindësit e hapësirës ballkanike, sidomos shqiptarët, ndaj gjuhës kishin qëndrim në shkallë të kultit dhe mitit, qëndrim që kufizonte me entuziazmin donkishotesk. Kështu, për De Radën “*gjuha mund të jetë, deri, shpirti më i ndjeshëm i popullit*”. Çdo shpërthim entuziast i shpirtit, lë gjurmë që dallohen nga gjurmët e tjera. Prandaj, vetëm gjuha njerëzore mund ta shprehë tërësisht disponimin e brendshëm të shpirtit, sepse fjalët, pa e humbur kuptimin e caktuar, e shprehin fizionominë dhe thellësinë e botës shpirtërore.

Duke u përqendruar në gjuhën shqipe, Jeronim de Rada është i bindur se, për nga pasuria, tërësia, plotësia e saj, kësaj nuk mund t’i afrohen as edhe gjuha italiane, gjuha greke, madje as gjuha latine. Ajo ua kalon atyre, sidomos me thjeshtësinë me të cilën është e zonja të shprehë nuanca më bujare të përjetësisë së gjërave dhe të sendeve. De Rada thotë se fjala është për një bindje përjashtimisht personale, por, nuk e përjashton mundësinë që në një përfundim të tillë të vijnë edhe ata që, një ditë do ta njohin dhe studiojnë gjuhën shqipe. Por sipas Jeronim de Radës, gjuha shqipe do ta nxisë vëmendjen, interesimin dhe kujdesin e studiuesve dhe gjuhëtarëve, në radhë të parë për dy arsye: së pari për fjalët e shumta të trashëguara nga e kaluara e lashtë (me siguri gjuha shqipe ishte folur nga një popull shumë

i mësuar, qofshin këta pellazgët ose dikush tjetër), sepse në të gjenden, jo vetëm burimet dhe kuptimet e politeizmit, por aty gjendet edhe një pjesë e fjalëve, të cilat i hasim edhe në eposet helene të Homerit. Së dyti, struktura e fjalive, e emrave personalë, është nga shumë aspekte, e ngjashme me gjuhën latine.

Ekzistojnë edhe një varg aspektesh që lidhen me gjenezën e gjuhës shqipe, me lashtësinë e saj dhe me qëndrueshmërinë nëpër shekuj, të cilat e nxitën për ngasje kërkimore Jeronim de Radën e madh. Megjithatë, pa një instinkt të brendshëm të iluzioneve mitike donkishoteske, nuk do të ishte i mundshëm një qëndrim aq stoik dhe i vendosur, kur kemi parasysh, sidomos mjedisin e huaj, ku qenë vendosur të parët e Jeronim de Radës pas çrrënjësjes nga toka e të parëve. Jeronim de Rada njësoj si edhe Skënderbeu në fushën e betejës, ndien thellë në vete se është i paracaktuar që ta vazhdojë luftën e madhe pas “humbjes së madhe”, që ishte humbje për tërë Evropën.

Arbëreshët, të cilët, e kishin dhe e kanë të lindur melankolinë për Motin e Madh dhe humbjen e madhe, me nostalgji të pashuar për vatrat e të parëve të tyre që i braktisën dhe nga ajo pjesë e detit Jon, u vendosën në tokë të huaj, sajuan rrethin e mbrojtjes nga shkrirja dhe asimilimi, duke u rrudhur në një si ishull gjuhësor, ku, me dashuri dhe fanatizëm, për më se pesë shekuj, do ta ruajnë gjuhën e të parëve, gjuhën arbëreshe. Prandaj, për Jeronim de Radën, mbështetja më e parë dhe më e madhe për ruajtjen e identitetit dhe dinjitetit të të parëve të kombit, do të jetë dhe do të mbetet gjuha arbëreshe.

E vetmja gjë që u ka mbetur shqiptarëve të përtej Adriatikut, shqiptarëve në Kalabrinë e Italisë, besonte Jeronim de Rada, është dashuria për tokën dhe gjuhën e të parëve dhe shpresa për jetë më të mirë e në liri. Prandaj, Jeronim de Rada u bën ftesë arbëreshëve ta ndihmojnë Rilindjen Shqiptare, duke ndjekur kështu edhe rrugën që bënte vetë ai gjatë tërë jetës. Mbetet, ndërkaq, dëshira dhe thirrja e tij në rrafsh të një Don Kishoti të lumtur, në rrafshin e një sizifi të bindur të fjalës.

Gjuhët e ruajnë esencën njerëzore, besonte thellësisht Jeronim de Rada. Mendimi i brendshëm, ndjenjat që janë, që jetojnë si strukturë gjuhësore, që qarkullojnë si enët e gjakut në trupin e njeriut, janë faktorët që e mbajnë gjallë një gjuhë, sado e vogël dhe sado pak njerëz që e flasin. De Rada si shembull më bindës për pohimin e tij, i përmend psalmet hebraike të Davidit ku shpirti shkëlqen si një vetëtimë, shumë më fort se sa në secilën gjuhë të popujve të mëdhenj.

Kështu këndonte De Rada në eposin epokal “Milosao”. Kështu shkruante Jeronim de Rada në librin e tij “Parime të estetikës”. Këndimi dhe shkrimi i tij poetik të nxit përfytyrimin e një Zarathustre mes Evropës dhe Ballkanit. Duke i takuar “sojit donkishotesk” të shkrimtarëve, Jeronim de Rada e dinte mirë se në një pjesë të qiellit, në mërgim, lundronte reja, thelbin e kuptimit të së cilës mund ta kuptonte vetëm ai dhe vetëm ai. Ndërkaq reja tretej në largësi, mbase duke arritur dhe duke u zhdukur në Arbërinë e tij të lashtë ose në Shqipëri... Ndoshta! Kështu besonte edhe ky Don Kishot shqiptar.

Universi “Milosao”

Në vitet '30 të shekullit XIX, me kryeveprën e Jeronim de Radës “Milosao”, njëra ndër kryeveprat e letërsisë sonë kombëtare, nis periudha e poezisë moderne shqipe. Nga kjo shkallë e rrezatimit artistik ajo po shkel edhe në shekullin e ri, të tretin me radhë në rrugën e vet, e sigurt se po me atë shkëlqim do ta vazhdojë jetën e vet nëpër mote. Autori i saj, ngjashëm me shkrimtarë të përmasave të mëdha, edhe të epokës së romantizmit së cilës i takon, në moshë fare të re, që me hapin e parë, u vërvit majave të artit poetik: me “Milosao”, Jeronim de Rada do të shënojë pikën më të lartë në tërë opusin e vet letrar, njërin ndër më të articularit në letërsinë tonë. Fuqia që ka më vete fjala, mundësia e saj për të gjallëruar bëma, pamje, gjendje në kohë e hapësirë, është natyrë, është mbështetje e parë e poezisë deradiane në veprën “Milosao”. Në laboratorin poetik të De Radës fjala del, shfaqet nga thellësitë e kohës, e përtërirë, e pastruar nga pluhuri, e kthjelluar nga përgjumja dhe, edhe pse e pakët si fond, si regjistër, do ta gjallërojë si art poetik përmes situatave të shpirtit dhe mendjes nga më të ndërlikuarat, më të nuancuarat dhe më të fshehtat në botën e njeriut. Fjala në poezinë e De Radës do të këndojë dridhjet më të holla që përftohen nga jashtë brenda dhe anasjelltas në shpirtin e Milosaos dhe të Rinës, njësoj siç do të artikulojë mbamendjen kolektive arbëreshe, të shkruara në këtë vepër si dy jehona në një sintezë letrare, në një monument të gdhendur poetik që quhet Milosao. Mbamendjen, Jeronim de Rada nuk e ka të mësuar nga librat, e ka të lindur, e ka në gjak, në fjalën arbëreshe të vatrës, të fshatit arbëresh dhe, si krijues i madh që qe, ai e ndjeu se pa gjallërimin dhe rigjallërimin e kujtesës zbehet kuptimi në jetën e njeriut: Ajo, kujtesa e përtërirë dhe e ripërtërirë e ushqen, e bën më njerëzor njeriun, e kuptimëson atë, ia ndriçon horizontin në ecje...

Çfarë prejardhjesh, çfarë përbërjesh janë ngasësit e muzës së shkrimtarit drejt *pushtimit* të kësaj kryevepre? Le të sjellim për një çast Jeronim de

Radën njëzetvjeçar të vitit 1834, student të saporegjistruar në Universitetin e Napolit, i cili gjatë një udhëtimi në fshat, zbulon në vete magjinë e dashurisë, lumturi të cilën ndjen nevojë ta përjetësojë në poezi, ta shqiptojë, ta ndajë atë lumturi me gjithësinë njerëzore. Dhe krahas kësaj ngasjeje të brendshme, djaloshit poet, që ishte edhe arbëresh, i ngulur shekuj më parë në vise të huaja, i zgjohet njëkohësisht edhe ngasja drejt rrënjëve, drejt origjinës përtej detit, ndjenjë, dije dhe ndër dije e shtresuar si trashëgimi, mall e vuajtje, mbase edhe si jehonë e largët për braktisjen e vatrave, si jehonë edhe më e largët faji dhe etje e pashuar nëpër mote për pastrim të gjitha këto e ngasës të tjerë pra zgjohen, alarmohen nga brenda të gatshëm, të pjekur për t'u artikuluar si art fjale. Kështu, Jeronim de Rada poet i formatit të madh, krahas kërkimit të dashurisë së beftë me Rinën i zgjohet edhe në kërkim të identitetit, në kërkim të dëshmimeve për të dy ngasjet. Rina iu shfaq si dritë çasti që përthith shpirtin, ndërsa zgjimin arbëresh e kishte më vete, të lindur. Edhe para këtij zgjimi të madh poeti kishte provuar të shkruajë ndonjë poezi në italisht, do të ketë qenë trokitje për hapje të portës së madhe, për hyrje triumfale në Panteonin e përjetshëm të poezisë shqipe. Kështu, studenti De Rada me njëzet vitet e veta, me dashurinë për Rinën, me fatalitetin e shtresuar arbëresh dhe me një regjistër aq modest të fjalës shqipe, por me talentin e madh, solli në dritë kryeveprën e quajtur “Milosao”.

Në krahët e këtij spektri ngasësish, muza e Jeronim de Radës do ta artikulojë universin Milosao. Duke iu dorëzuar zgjimit Rina dhe zgjimit arbëresh, ai do të thurë një drejtpeshim të përsosur poetik mes dy zgjimeve, drejtpeshim i cili në fillim vjen ideal, meqë ishte përcaktim sovran i brendshëm. Gjithnjë drejt këtij vizioni harmonik, Milosao do ta strehojë dashurinë e vet nën harkun kohor të Motit të Madh dhe si hapësirë në gjirin e Shkodrës, por ama dorëzimi i lumturisë së quajtur Rina do të jetë i pari. Si drejtpeshim i tillë, si harmoni e poetit me vetveten do të zhvillohet dhe shtjellohet odisejada, drama e Milosaos edhe pse në momente gjatë fragmenteve të lumturuara të jetës, ndër gjegjja e tij do të jetë e ngarkuar me qortimet e Mëmë madhes, që biri i saj nuk i dorëzohej i tëri zgjimit arbëresh, e që me këtë rast është zë që simbolizon jehonën e lashtë nga Moti i Madh. Vetëm në fund të jetës, pasi vdekja ia rrëmben më të dashurit, djalin njëherë pastaj edhe gruan, Milosao me ndjenjën e lehtë të fajit dhe pastrimit, do të dorëzohet i tëri në krahët e prijësit kombëtar për mbrojtjen e atdheut.

Brenda një fragmenti kohor nga jeta e Milosaos, të ngjeshur me bëma, Jeronim de Rada ka thurur universin e quajtur Milosao ngjashëm me universin e ekzistencës së njeriut, univers i rumbullakësuar me fillim dhe fund dhe me të gjitha fazat e kësaj ekzistence njerëzore. Ai, Milosao, e nis